

# THANAS ZIKO

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

92  
771

SPIRO  
XHAI



92  
771

SPIRO XHAI

R

# THANAS ZIKO



35660

SHTËPIA BOTUESE E «LIBRIT POLITIK»

## NJË EMËR QË MBETI NË HISTORI

Nëntori kishte ardhur atë vit me furtuna të njëpasnjëshme dhe shira të pambaruara. Përrenjtë e maleve qenë fryrë sa asnjëherë tjetër, duke përmbytur fshatra, fusha e lugina. Lumenjtë vërshonin me rrëmbim mbi shtratin e tyre të ngushtë dhe gjëmonin si bisha të tërbuara.

Një çetë e vogël, që vinte nga mali, arriti në breg të lumit Drino që sa i urtë është në verë, aq i papërmbajtur dhe i egër bëhej në dimër. Nata ishte e errët pus. Nuk shihej asnjë yll në qiell, asnjë shenjë drite përreth. Vetëm andej nga kalon xhadeja, buzë kodrave të zhveshura, dukeshin herë pas here drita shumëgjyrëshe. Armiku, i struktur në disa bunkerë pranë urave dhe kryqzimeve të rrugëve, kërkonte të largonte frikën me anë të këtyre fishekzarreve (se nata është me barrë, thotë populli, dhe nuk dihet se ç'mund të lindë e ç'mund të ndodhë). Një natë e tillë e shqetësuar s'mund t'i sillte gjë tjetër armikut, përveç goditjeve të befasishme dhe humbjeve të papritura.

Mesnatë. Çeta ndodhej në kërthizën e Fushës së Dropullit të kthyer në moçal. Lumi duhej kaluar

para se të agonte dita e re. Po si mund të kapërcej  
hej një lumë i fryrë tejpërtej, që oshëtinte si një  
sundimtar i plotfuqishëm i kësaj nate dimri?

— Të gjejmë disa kuaj, — tha komisari.

— Edhe me kuaj vështirë do të jetë të kalojmë  
matanë. Lëre pastaj që, sa të gjenden kuaj e të  
bëhet kalimi një nga një a dy nga dy, do të jetë  
gdhirë. Lumi duhet të kapërcehet shpejt dhe pa  
zhurmë, se armiku përgjon. Ai ditën ka të fortë  
syrin, ndërsa natën veshin, — tha me gjakftohtësi  
komandanti.

— Atëhere?

— Të bëjmë një zinxhir të fortë, — propozoi  
një partizan i shkurtër, që sapo kishte lënë hoste-  
nin e kishte rrëmbyer pushkën dhe i njihte mirë  
ato vende, ashtu si njihte po aq mirë edhe huqet e  
lumenjve e të përrenjve.

— Zinxhir? Po me se?

— Me duart tona!

Çeta ishte e vogël, por zemrën e kishte të  
madhe dhe idealin, për të cilin kishte marrë armët  
për të luftuar, e kishte të lartë. Dhe zinxhiri i duar-  
ve të partizanëve, i farkëtuar nga zjarri që flakë-  
ronte në zemrat e tyre, e munda hovin e papërmbaj-  
tur të lumit të turbullt...

Atë natë nuk ishte vetëm ajo çetë e vogël në lë-  
vizje. Ashtu si zbresin me rrëmbim përrenjtë nga  
malet, ashtu lëviznin pa pushim nga të gjitha anët  
guerriljet e fshatrave, çeta të reja e batalione të  
sapoformuara. Fshatarët kishin lënë parmendën e  
bujkut e kërrabën e çobanit dhe kishin zënë push-  
kën e luftëtarit.

Ishin ditë plot ngjarje, ndryshime, përmbysje.

Telegrafi partizan punonte pa pushim. Lajmet vinin njëri pas tjetrit: «Libohova, pas një lufte të rreptë kundër ballistëve, u çlirua», «Në Gjirokastrë hynë partizanët». Këtu formohej një batalion i ri, atje lindte një çetë e re. Ishin këto lajme të gëzuara që ngrohnin zemrat e partizanëve në lëvizje. Çeta marshoi pa pushim gjatë gjithë natës e madje edhe në mëngjes. Ishin ditët e stuhishme plot ngjarje e ndryshime të nëntorit të vitit 1943...

Ndërsa Drinosi fryhej nga ujërat që zbrisnin nga malet, çeta, që kishte kaluar natën e errët lumin e turbullt, po bëhej çdo ditë e çdo orë më e madhe nga partizanët e rinj që vinin për t'u rreshtuar në radhët e saj. Ata dilnin grupe-grupe nga fshatrat e Dropullit, të Pogonit e të Rrëzës së Zezë, që ato ditë, nga lëvizja e madhe e partizanëve, mund të quhej fare mirë «Rrëzë e kuqe». Të gjithë vinin e bashkoheshin në çetë. Kështu që, kur ajo hyri në Gjirokastrën e çliruar, nuk ishte më çetë por një batalion. Forcat e saj ishin ndarë në tri kompani, ashtu siç ndaheshin në atë kohë batalionet partizane. Ajo kishte edhe pushkë, edhe mitralozë, edhe një mortajë të vogël. Por një diçka i mungonte. Batalioni i porsaformuar ende nuk kishte një emër. Ja, ky batalion pa emër hyri në fshatin më të madh të Dropullit, në Derviçan. Këngët partizane jehuan më fort se bubullimat e asaj nate vjeshte. Dhe rrugët e ngushta të fshatit të madh u mbushën me burra, gra e fëmijë, që prisnin me buzëqeshje e zemër të hapur bijtë dhe bijat e tyre të armatosura. Vetëm disa fytyra të errëta strukeshin në buxhak si kukumjaçka të tmerruara nga drita dhe dridheshin e përdridheshin, megjithëse zjarrin e kishin fare pranë në oxhak...

Një ditë më vonë batalioni i ri u rreshtua në sheshin e madh të fshatit. I dërguari i Komitetit Qarkor të Partisë për Gjirokastrën u foli partizanëve të rinj për problemet e kohës dhe detyrat e luftës. Në fund ai shtoi:

«Batalioni juaj i porsaformuar do të marrë emrin e revolucionarit Thanas Ziko!»

Nga rreshtat e partizanëve u dëgjuan disa zëra:

— Kush ka qenë ky Thanas Ziko?

— Nga ishte?

— Ç'ka bërë?

— Ne për herë të parë e dëgjojmë këtë emër!

— Thanas Ziko ishte nga fshati Sopik. Ai ka qenë djalë i vegjëlisë si unë e ti e tjetri e tjetri, — u hodh një partizan i gjatë nga Sopiku i Pogonit.

— Mirë që ka qenë nga fshati yt, po ç'ka bërë pa...

— Ai s'ka punuar këtu në qarkun tonë, por andej nga Tirana e nga Berati e më shumë jashtë shtetit.

— As ti nuk e di mirë historinë e tij?

— Unë di kryesoren, — u përgjegj me bindje partizani i gjatë nga Sopiku i Pogonit. — Ai ka qenë militant komunist dhe ka vdekur duke luftuar për komunizmin.

Thanasi ka qenë një revolucionar dhe, ashtu siç tha edhe ai bashkëfshatari i tij, ai ka punuar e vepruar më shumë jashtë Shqipërisë, në Francë, Jugosllavi e gjetkë, — e mori përsëri fjalën i dërguari i Komitetit Qarkor të Partisë. Dhe e mbylli kështu bisedën e tij me partizanët: «Ju tani, shokë, do ta mësoni mirë historinë e Thanas Zikos, emrin e të cilit ka marrë

batalioni juaj. Dhe jo vetëm do ta mësoni, por me siguri që do ta plotësoni e do ta pasuroni me ngjarje, luftëra dhe heroizma të reja».

Kështu e nisi rrugën e tij luftarake një batalion i ri, që përbëhej nga djem e vajza të minoritetit në Shqipëri. Ky batalion, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare dhe nën drejtimin e Shtabit të përgjithshëm, luftoi për krah me partizanët e tjerë shqiptarë, shkroi me gjak faqe të reja heroizmi dhe hyri në historinë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, pjesë përbërëse e së cilës ka qenë.

Dhimitër Shuteriqi, shok i ngushtë dhe bashkëluftëtar i Thanasit në luftën kundër fashizmit gjatë viteve të vështira të emigracionit jashtë atdheut, shkruan për këtë batalion:

«Gjatë luftës nacionalçlirimtare, kur për herë të parë kam dëgjuar se në qarkun e Gjirokastrës luftonte një batalion partizan, i cili mbante emrin e Thanas Zikos, më bëhej sikur e shihja Thanasin të gjallë, në krye të batalionit vetë, tek sulmonte, i madh siç ishte në shtat, me ata sy të mëdhenj që i shkrepëtinin rrufeshëm kur përmëndej emri i armikut, me atë trup gjithë eshtra e kokalla të forta, që shprehte një forcë të jashtëzakonshme karakteri dhe një gatishmëri të rrallë për të sulmuar...»

Më kujtohet një takim që kam patur me nënën e tij plakë pas çlirimit, së cilës i thashë dy fjalë për Thanasin, të cilin kisha patur fatin ta njihja jo shumë muaj përpara se të vdiste. Plaka e urtë më tha: «Jo, more bir, nuk sosi dot këtu, që të na kishte parë e ta shihnim dhe një herë, të shihte se si lufta nisi dhe të mbyllte sytë. Po ai këtu ka

qenë, more bir. Ti ke dëgjuar për batalionin «Thanas Ziko». Zëre se ishte Thanasi vetë në luftë», — dhe tregoi diçka me dorë tutje, sikur me atë gjest të desh të tregonte trimëritë që u bënë me emrin e tij emblemë partizanësh...»



## NISJA E SHTEGTIMEVE

Në prak të vjeshtës mëngjezet janë të bukura e të freskëta në fshatrat malore të krahinës së Pogonit. Shpatet e pjerrëta të Nemërçkës mbulohen me lule shumëgjyrëshe, ashtu si fushat në pranverë. Kopshtijet e vreshtat, të ngarkuar me rrush e pemë të arrira, sikur i ftojnë kalimtarët për një vizitë... Pyjet e Opsadhës e të Makrikampit vishen me ngjyrrat më të bukura e më të larmishme. Në këtë stinë, vozaxhinjtë e Sopikut, të fshatit më të madh të kësaj krahine të largët, merrnin monopatet e kthimit për në vatrat familjare. Por kishte edhe të tjerë që pikërisht në këto ditë të bukura bëheshin gati të linin folenë e ngrohtë familjare e të merrnin rrugën e vështirë për në vende të largëta e shtigje të panjohura...

Pa shkrepur mirë rrezet e para të diellit, në majat e larta të Nemërçkës, nga një shtëpi e vogël e lagjes Filiates të Sopikut doli një djalosh i gjatë dhe i hollë, i veshur gjysmëfshatar e gjysmëqytetar, me një bohçe në dorë. Rrugët e fshatit në prak të agimit të ditës së re ishin ende të shkreta. Aty-këtu dëgjoheshin zilet e dhive, që dilnin tufa-tufa

nga oborret e shtëpive për të shkuar në kullotë. Djaloshi herë-herë qëndronte në mes të rrugës e vështronte rreth e rrotull sikur kërkonte të përshëndetej me gurët e rrugës, ku kishte bërë hapat e para, dhe me drurët e lagjes, ku kishte luajtur i shkujdesur me shokët e fëmijnisë.

Pas tij doli një grua jo shumë e kaluar nga mosha, por e plakur para kohe nga puna e rëndë e nga hallet e jetës. Ajo mbante prej kapistre një gomar që kishte si ngarkesë vetëm një velenxë ngjyrë portokalli, të cilën e kishte punuar vetë me duart e saj. «Ç'e do velenxën, moj nënë?», — i kishte thënë djali kur bënin gati sendet që ai do të merrte me vete. «Dimrin e kemi përpara, mor djalë! Me se do të mbulolesh natën nëpër shtëpitë e botës?» «Unë desha të kisha vetëm një bohçe dhe asgjë tjetër, sepse, kur je në rrugë, për bela i ke plaçkat e tepërta. Lere pastaj që mund ta harrosh në ndonjë vend e të humbasë». «Për këtë më mërzitesh ti? Le të humbasë! Ti të jesh shëndoshë e mirë, pa të tjerat...», — dhe s'kishte arritur ta mbaronte fjalën, se ishte shkrehur në lot. Ajo i thirri të birit me një zë çuditërisht të ndryshuar:

— Thanas! Sille bohçen ta ngarkojmë në gomar. Rruga është e gjatë, o bir, shumë e gjatë dhe do të më lodhesh.

Djali ja dha bohçen pa i thënë gjë. Ai dukej shumë i menduar dhe në zemër sikur ndjente një peshë të rëndë. Ishte hera e parë që largohej nga shtëpia për një udhëtim të gjatë drejt së panjohurës, hera e parë që linte fshatin e tij të lindjes e merrte rrugën e botës së madhe...

Nëse djali ishte i menduar e melankolik, e ëma

ishte shumë e tronditur. Dhe tronditja e brendshme e një nëne nuk mund të fshihet nga asnjë përpjekje e jashtme. Ajo shaminë e bardhë të grave të Pogonit e kishte shtrënguar fort në kokë si për të larguar një dhimbje të fortë, që nuk e kishte lënë gjithë natën të vinte gjumë në sy. Sot ajo po përcillte djalin e saj të vetëm për një udhë të largët. Shumë kujtime të hidhura përplaseshin në shpirtin e saj dhe shkriheshin në një me dhimbjen e sotme. Kështu si sot, para shumë vjetësh, ajo kishte përcjellë burrin për në kurbetin e zi. Njëzet vjet kishin kaluar që nga ajo ditë e largët dhe ai s'e kishte shkelur më prakun e shtëpisë. Një jetë të tërë ajo po kalonte vetëm si «grua e ve me burrë të gjallë». Djali i saj i vetëm, Thanasi, ishte rritur si jetim, megjithëse të atin e kishte gjallë. Ndaj nëna ishte betuar në heshtje që djalin e saj ta mbante gjithnjë pranë.

Pasi kishte mbaruar shkollën fillore në fshat. Thanasi kishte nisur të merrej me punët e shtëpisë. Por pas një kohe i kishte thënë së ëmës: «Nënë, unë do të iki nga fshati. Do të shkoj në Durrës ose në Tiranë për të kërkuar ndonjë punë».

Herën e parë ajo ja kishte prerë shkurt: «S'ke për të vajtur gjëkund, jo! Ua kemi parë hairin qyteteve. Kështu u nis edhe yt atë dhe humbi pa nam e pa nishan në kurbet. . .»

Por djali nuk qe tërhequr. Pas disa ditësh i kishte thënë përsëri: «Moj nënë, unë s'rri më pa punë, më duart në xhep! Ç'të bëj këtu, të vras mi-zat? Ja, djali i doktorit, me të cilin mbaruam bashkë shkollën fillore, vajti në gjimnaz. Edhe djali i bakallit po vazhdon shkollën e mesme, megjithëse ka qenë firifiu nga mendja dhe i fundit në mësime. Me-

që ne s'kemi takat për shkollë, unë do të kërkoj ndonjë punë, çdo punë që të jetë».

«Unë them, mor djalë, që ti të bëhesh marangoz. Yt atë e yt gjysh kanë qenë vozaxhi. Hallatet e zanatit i kemi, se marangoz e vozaxhi kushërinj të parë janë. Pse më zë në gojë punëra të tjera? Ku do të shkosh ti për të kërkuar punë? Kush të pret atje? Pastaj mendo edhe këtë: si do të më lësh mua këtu në fshat si qyqe?»

Fjalët e fundit të nënës sikur e kishin thyer për një kohë vendosmërinë e djalit. Ai kishte marrë sqeparin, zdrukun dhe sharrën e gjyshit dhe kishte filluar të rregullonte shtëpinë, të ndërronte dyert e vjetra me të reja, të bënte dritare më të mëdha e më të bukura, të ndreqte dyshe-menë e prishur...

Por kjo punë nuk hapte asnjë perspektivë. Ai shihte marangozët e tjerë të fshatit që sorrollateshin poshtë e lart për të siguruar punë. Po kush ndërtonte shtëpi të reja në atë kohë? Kriza e madhe ekonomike po përhapej kudo. Prandaj Thanasi një ditë kishte marrë vendim të prerë. Në mbrëmje, kur kishin shtruar sofrën për të ngrënë një copë bukë, ai i kishte thënë së ëmës: «Unë s'rri më këtu! Pas një jave do të nisem. S'kemi ç'të bëjmë, moj nënë!»

E ëma s'mund t'i kundërshtonte më të birit.

Në çastin që përcillte djalin, ajo thoshte me vete. «S'bëra mirë që lëshova pe! Të kisha ngulur këmbë më shumë që të mos nisej! Se si më duket tani, sikur më shkulet zemra nga kraharori e fluturon diku larg!» E rëndë kishte qenë për të ndarja nga burri një vit pas martesës. Por njëmijë herë më e rëndë i dukej ndarja nga djali i saj i vetëm në atë mëngjez të freskët e të bukur vjeshte. Për një

kohë nën e bir ecën në heshtje. Dielli shkrepí me madhështi mbi majat e larta të Nemërçkës. E ëma hodhi një vështrim të shpejtë rreth e rrotull, vuri re se ora kishte kaluar dhe nxitoi hapat, sepse e dinte se rruga që kishin për të bërë ishte më e gjatë se dita e shkurtër e vjeshtës. Monopatet gjarpëronin përmes shkurreve e korijeve të dendura, por ajo i kishte shkelur aq shpesh këto vende, saqë mund ta gjente drejtimin edhe symbyllazi.

Përpara tyre u duk një grykë e thellë, gryka e Selckës që, kur hyn atje, mund të vështrosh vetëm një rrip të ngushtë qielli dhe male të egra të zhveshura. Djaloshi ktheu edhe një herë kokën për të vështruar Nemërçkën krenare, sikur do të përshëndetej me të për herë të fundit.

Nga një shkëmb i lartë i rrethuar nga rrepa të mëdha e të hieshme dilte një burim mali me ujë të kristaltë. Djali ju afrua burimit, lau fytyrën dhe u bë gati që të pinte ujë me të dyja pëllëmbët e duarve.

— Thanas, mos pi ujë, se je i djersitur! — i thirri e ëma.

— Pak, sa për të freskuar gojën...

— Ujë si ky s'ka në botë, — i tha ajo duke i vajtur pranë. — Gjithë kurbetçinjtë, para se të largoheshin nga fshatrat tona, pinin ujë në këtë burim që të mos harronin njerëzit që linin prapa. Ndash, mor bir, çlodhu pak e pastaj pi sa të duash, që të mos na harrosh.

Djali i buzëqeshi lehtë së ëmës. Kjo buzëqeshje e thjeshtë që për shpirtin e zhuritur të saj si një premtim i madh plot shpresa për të ardhmen...

Ishte ngrysur kur mbërritën në Gjirokastër. Ata siguruan një dhomë për të fjetur dhe një vend për

kafshën në hanin e vjetër të qytetit. Natën, megjithëse ishin të lodhur nga rruga e gjatë, e ëma i dha edhe një herë këshillat e fundit. Ai kushedi sa herë i kishte dëgjuar porositë e saj. Por në dhomën e vogël të hanit të vjetër këto këshilla të nënës sikur merrnin një rëndësi tjetër më të madhe dhe një kuptim të ri. Në mëngjez, kur hapi sytë, ai pa nënën të përkulur mbi shtratin e tij.

— U zgjove, nënë? — e pyeti ai si me habi. Ajo nuk ju përgjegj, por u përkul edhe më për t'i përkëdhelur flokët e zez.

Kushedi, ndoshta ajo gjithë natën s'kishte mbyllur sy! Kishte ardhur çasti i hidhur i ndarjes. Ajo do të kthehej përsëri në fshat. Oh, sa punë e prisnin nënën atje!

Tani ishte djali që e përcillte nënën gjer në fund të rrugës së ngushtë të qytetit të lashtë të shtruar me kalldrëm. Në çastin e fundit ajo e shtrëngoi të birin në krahor dhe i pëshpëriti në vesh:

— Thanas! Vafsh shëndoshë, biri im! Dhe të më shkruash letër sapo të mbërrish atje. Ta dish, unë do të rri duke pritur postierin. . .

Dhe ja mbuloi fytyrën me të puthura e me lot. Sa gjëra donte t'i thoshte ai atë çast! Por zëri i ngeci në fyt. Ai e vështroi të ëmën gjersa ajo humbi tutje në fushën e mbuluar nga mjegulla e mëngjezit.

Tani ai duhej të intereshej për të gjetur maqinë, që të nisej për në Tiranë. Në agjenci i thanë se pas dy ditësh mund të nisej një kamion. Nuk ishte e lehtë në vjeshtën e vitit 1929 të gjeje maqinë për të udhëtuar nga Gjirokastra për në Tiranë. . .

Në mbrëmje u kthye shpejt në han dhe ra menjëherë të flinte.

## FRAGMENTE NGA ËNDËRRIMET E NJË TË RIU...

Në vitet e fëmijnisë së Thanasiq zanati i voza-xhiut kalonte një krizë të madhe. Vozaxhinjtë nuk ndërmerrnin më udhëtime të gjata për në Morenë e largët e për në Vllahi matanë Danubit. Po ata nuk qëndronin as në fshat, pranë familjeve të tyre. Çfarë do të bënin në fshat? Ku do të punonin? Tokat më të mira nga ato që ishin çelur me djersë e mundime shkrepave dhe shpateve të malit ishin në duart e disave, në duart e pasanikëve. Një pjesë e mirë e arave, e vreshtave dhe kullotave kishin kaluar në duart e kishës. Sopiku vërtet s'kishte patur kurrë çifligarë, por ja që edhe në tokat e tij të varfëra kishte një çifligare që quhej kishë. Pasurinë që kishte grumbulluar kjo çifligare e re, e administro-nin dhe e shfrytëzonin epitropët e kishës, domethënë pasanikët e fshatit. Të varfërit nuk mund të gje-nin punë as në qytetet e afërta të vendit. Nevoja i detyroi, që të çanin dete e oqeanë për të vajtur në Amerikë, në Argjentinë, në Afrikë e gjer në Au-strali. Rrugën e kurbetit të zi nuk e bënin pak veta, por pjesa më e madhe e burrave e, në mënyrë të ve-

çantë, të rinjtë, Në fshat mbeteshin vetëm gratë, pleqtë e disa pasanikë parazitë, që jetonin me djer-sën e të tjerëve. Të gjitha punët në shtëpi e në arë i bënin gratë. Ato çanin tokën me parmendë, ato punonin në vreshta, ato merreshin me qeverisjen e shtëpisë dhe me rritjen e fëmijëve. Ku e kërkonin nevojat e familjes, gratë e Pogonit të largët kapërce-nin malet dhe ktheheshin të ngarkuara me gjysmë thesi misër që e blenin në pazaret e Libohovës e të Gjirokastrës. Pranë fshatit Sopik është një vend që edhe sot e kësaj dite quhet «Fonjas» (Vrasës), sepse në atë qafë të vështirë për t'u kaluar kishin gje-tur vdekje nga stuhia e borës tri gra sopiçote, që ktheheshin të ngarkuara me bereqet.

Thanasi i vogël shikonte bashkëfshatarët që përcillnin njerëzit e tyre për në kurbet. Gra, pleq e fëmijë shoqëronin burrat e shtëpisë gjer në një vend që quhej Kumashë. Atje ndaheshin me lot në sy. Në fshat thoshin se në Kumashë nuk mbinte asnjë fije bari nga lotët e nxehta të nënave e të grave që ndaheshin nga fëmijët e nga burrat e tyre.

Edhe i ati i Thanasit, Aleks Zikoja, menjëherë pas martesës ishte nisur si vozaxhi për në Rumani. Por edhe atje ai e kishte parë veten ngushtë. Punë nuk gjente lehtë. Edhe kur gjente, mezi siguronte bukën e gojës. Po familjen në fshat kush do ta mbante? Atë kohë kishte filluar mërgimi në masë për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndaj vendosi të provonte fatin në një kurbet edhe më të largët. Së bashku me disa vozaxhinj të tjerë, pa u kthyer fare në fshat, u nis për në Amerikë. Thanasi e kishte parë të atin vetëm në fotografi. Ndaj në fshat i thoshin «jetim me të atin gjallë». Atë e rriti



e ëma, Kaliopi Ziko, e cila u bë për të edhe nënë, edhe babë.

I ati në fillim i dërgonte familjes letra dhe ndonjëherë edhe ndonjë para. Por pas 4-5 vjetësh u shkroi një letër që i hidhëroi pa masë njerëzit e shtëpisë. Ai kishte mbetur pa punë dhe do të provonte fatin në një qytet tjetër. Por edhe atje ku shkoi, nuk i vajti mbarë. Letrat bëheshin gjithnjë më të rralla, gjersa pushuan fare. Letra e fundit që erdhi nga Amerika në shtëpinë e Zikojve njoftonte lajmin e vdekjes së Aleks Zikos në Amerikë.

Kështu, Thanasi mori rrugën e madhe të jetës në një kohë shumë të vështirë. Ai u largua nga fshati se atje nuk kishte as punë e as ndonjë perspektivë për të ardhmen. Po edhe atje ku do të shkonte, ai nuk e dinte se me ç'punë do të merrej. Ndonjë pregtatije të madhe për të përballuar vështirësitë e reja të jetës nuk kishte. Në fshat kishte mbaruar shkollën fillore në gjuhën greke. Gjuhën shqipe ende nuk e njihte mirë. Gjithashtu, nuk kishte mësuar asnjë zana nga ata të fshatit. Një përpjekje që kishte bërë për të mësuar zanatin e marangozit nuk e kishte çuar deri në fund, sepse, edhe po ta mësonte këtë zana, nuk shihte asnjë perspektivë për të siguruar jetën.

Gjatë kohës që kishte mbetur në fshat, pas mbarimit të shkollës fillore, Thanasi i kishte ndihmuar së ëmës në punët e bujqësisë, në vreshtin e Opsathës dhe në arat e vogla të shpërndara andej-këtej brigjeve dhe shpateve të malit. Në dimër, kur s'kishte ç'të bënte, mërzitej shumë. Po t'i binte në dorë ndonjë libër, e lexonte me një frymë. Më tepër e tërhiqnin librat që flisnin për luftërat e të parëve tanë kundër pushtuesve të huaj dhe bashkëpunëtorëve të

tyre vendës. Shumë gjëra nga ato që lexonte në libër mundahej t'i krahasonte me ngjarjet që kishin ndodhur ose po ndodhnin tani në fshatin e tij të lindjes. Nga sa kallëzojnë shokët e tij të fëmijnisë, Thanasin e shqetësonte që në moshë të re fati i bashkëfshatarëve, vuajtjet e tyre dhe lufta pa mbarim për të siguruar krodhen e bukës në një tokë malore e të varfër, që gjendej shumë larg linjave të komunikacionit dhe qendrave të rëndësishme të vendit.

Sopiku i Pogonit nuk ishte vetëm fshati i vozxhinjve shtegtarë, por edhe vendlindja e shumë luftëtarëve të paepur kundër pushtuesve të huaj dhe shfrytëzuesve. Sa histori prekëse kishte dëgjuar ai nga të vjetrit për njerëzit e pushkës që kishte nxjerrë fshati i tij i lindjes! Sa shumë ishte entuziazmuar kur kishte dëgjuar bëmat e Jani Gegës kundër ushtrive të pushtuesit! Një fshatar ka qenë ky Jani Gega nga Sopiku i largët. Por ai kishte guxuar të përleshej me një repart të tërë suvarish, të cilët kishin vajtur në fshat për të terrorizuar popullin. Komandanti i suvarive i kishte vënë syrin motrës së bukur të Jani Gegës, i cili në çastin e rrezikut më të madh dhe për të shpëtuar nderin e motrës, kishte rrëmbyer pushkën që e mbante të fshehur, kishte vrarë komandantin turk së bashku me katër suvaritë dhe kishte dalë malit për të vazhduar luftën kundër dushmanit, që i kishte shkelur vatanin.

Më tërheqëse dhe më interesante ishin përpjekjet dhe luftërat e Nasho Velos kundër pasanikëve të fshatit dhe klerit. Nasho Veloja kishte qenë një njeri i varfër dhe i këputur nga Sopiku i Pogonit, që vite me radhë kishte punuar si hyzmeqar në pronat e kishës. Shfrytëzimi i pamëshirshëm i

klerikëve dhe pasanikëve, që administronin pronat e kishës sikur të ishin çifliku i tyre, po bëhej nga dita në ditë më i padurueshëm. Dhe një ditë në fshat plasi revolta e varfanjakëve. Nasho Veloja u vu në krye të fshatarëve të varfër të revoltuar. Priftërinjtë e fshatit me aprovimin e peshkopit të Gjirokastrës e mallëkuan dhe e shkishëruan Nashon në mënyrë që ta frikësonin e ta bënë të hiqte dorë nga lufta e armatosur. Por ai i hodhi poshtë me përbuzje këto masa mesjetare të kishës dhe jo vetëm nuk u përkul, por i dha luftës së tij kundër pasanikëve dhe klerikëve një hov edhe më të madh. Në gusht të vitit 1889 Nasho Veloja në krye të fshatarëve të varfër ndërmoi një sulm të guximshëm kundër pasanikëve dhe klerikëve, që ishin strukur në shtëpitë e tyre të bukura në qendër të fshatit. Njëmijë shpifje kishin sajuar pasanikët dhe klerikët kundër Nasho Velos duke e paraqitur atë si hajdut e kusar. Por këto shpifje nuk i hante populli. Natën e sulmit vendimtar Nashoja, si gjithnjë, ecte në krye të luftëtarëve të tjerë. Kur ju afrua shtëpive të para të fshatit, mori një hinkë dhe thirri me të madhe që ta dëgjonte gjithë fshati: «Mos u tremb, o popull fukara i Sopikut! Ne po vimë për të qeruar hesapet me pasanikët e fshatit e me priftërinjtë. Ne jemi vëllezërit tuaj!» Dhe fjalën ai e mbajti. Kur hyri në fshat, sulmin e drejtoi kundër tri shtëpive të arhonëve më të dëgjuar të fshatit.

Lufta e fshatarëve të varfër që udhëhiqej nga Nasho Veloja pati një karakter të hapur klasor. Ajo vazhdoi disa vjet me radhë. Për të shtypur revoltën e fshatarëve të varfër të Sopikut, para se ajo të përhapej edhe në fshatrat e tjera të krahinës, kishin

ardhur nga qendrat forca të shumta të ushtrisë turke. Në këtë mënyrë u provua edhe një herë tjetër se shfrytëzuesit vendës, kur e kërkonte interesi i tyre klasor, hynin në bashkëpunim të hapët me pushuesit e madje viheshin edhe në shërbim të tyre plotësisht.

Pas dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjetësh Nasho Velon e vranë ushtarët turq në pabesi. Në një përlëshje me një repart turk Nashoja vrau disa ushtarë armiq, por në fund u plagos dhe ra në duart e repartit të ndjekjes. Në kujtim të këtij luftëtari të paepur populli i Sopikut ka ngritur një këngë të bukur, që Thanasi e dëgjonte nga goja e fshatarëve të tij kur e këndonin në raste festash e dasmash.

Në ato vite të rinisë së parë të Thanasit në fshatin Sopik ndodhi një ngjarje që sopiqotët nuk do ta harrojnë kurrë. Edhe Thanasi e mbante mend gjithnjë sa që gjallë dhe ua kallëzonte shokëve të tij të ngushtë me një kënaqësi të veçantë.

Ishte fillimi i vitit 1925. S'kishin kaluar më shumë se katër pesë javë që nga dita kur kishin hyrë në Tiranë mercenarët e Ahmet Zogut, të cilët sollën në fuqi një qeveri reaksionare, që do t'i shërbente verbërisht feudoborgjezisë. Duke filluar nga qendra, vala e terrorit dhe e ndjekjeve kundër patriotëve dhe njerëzve përparimtarë po përhapej me shpejtësi anembanë vendit. Në mes të dimrit në krahinën e largët të Pogonit u futën xhandarët dhe bashibozukët e Zogut për të çarmatosur e për të shtypur egërsisht popullin. Ata e filluan aktivitetin e tyre kriminal nga Sopiku, që ishte fshati më i madh dhe më i largët i krahinës. Me pretekst se do të bënin një komuni-

kim me rëndësi të qeverisë, mblodhën gjithë burrat e fshatit në oborrin e shkollës dhe me ashpërsi kërkuan nga fshatarët t'u dorëzonin të gjitha llojet e armëve, duke filluar që nga thikat e nga revolet e gjer te pushkët e çdo lloji. Meqë burrat e Sopikut ju përgjegjën se në fshat nuk kishte armë të fshehura, xhandarët filluan nga torturat. Pa e zgjatur shumë me fjalë xhelatët e qeverisë reaksionare i merrnin një nga një burrat e fshatit në një bodrum, i lidhnin me litar dhe fillonin t'i rrihnin barbarisht. Lajmi për këtë gjëmë që kishte pllakosur fshatin u përhap me një shpejtësi të rrufeshme në të pesë lagjet e Sopikut. Gjendja ishte kritike. Atmosfera po bëhej nga çasti në çast më e rëndë. Xhandarët ulërinin egërsisht: «O dorëzoni armët, o do t'ju marrim shpirtin!»

Atëhere ndodhi ajo që s'mund të pritej kurrsesi nga xhandarët e dërguar nga qeveria reaksionare e Tiranës. Gratë e Sopikut, që dinin të përdornin me mjeshtëri belin e drapërin, që bënin ugar me parmendë, mund të mbanin fare mirë edhe armët, po të që nevoja. Dhe këtë ato e treguan atë ditë dimri të vitit 1925. Shtëpi më shtëpi e avlli më avlli, ato u muarën vesh midis tyre dhe në orën e caktuar, pasi rrëmbyen sëpata, kosore e çomagë, u sulën me të thirrura të forta kundër mercenarëve të qeverisë, që u torturonin burrat. Në qendër të fshatit ndodhi një përlëshje e madhe. Ajo nuk vazhdoi gjatë. Gratë u futën në shkollë dhe liruan burrat e arrestuar. Pastaj u kthyen nga xhandarët, i çarmatosën dhe i përzunë me zemërim duke i përcjellë gjer matanë kufirit të fshatit.

Kjo revoltë e grave të Sopikut kundër barbariz-

imave të qeverisë së Zogut bëri përshtypje të madhe jo vetëm në gjithë fshatrat e Pogonit, por edhe jashtë kufive të kësaj krahine. Autoritetet e qarkut, sipas udhëzimeve që muarën nga qendra, nuk kundërvepruan në atë kohë, me qëllim që të mos e acaropinin edhe më shumë gjendjen jo të favorshme për ta. Operacionin e çarmatimit të popullsisë e vazhduan, sigurisht, edhe në fshatrat e tjera të Pogonit. Por tani e tutje zbatonin një taktikë më elastike e më të butë. Gratë e Sopikut u kishin dhënë një mësim të mirë.

Ngjarjet e përlëshjet që shpërthenin kohë mbas kohe në këtë fshat të madh me treqind e ca shtëpi kanë luajtur një rol jo të vogël në formimin dhe në kalitjen e karakterit të të riut Thanas Ziko. Thanas Mari, moshatar dhe mik i ngushtë i Thanas Zikos, tregon: «Thanas Zikoja i vërente me kujdes ato që ndodhnin në fshat. Ai kishte një kujtesë të fortë dhe mbante mend jo vetëm ngjarjet e kohës, por edhe kallëzimet e të tjerëve për ngjarjet e së kaluarës. Sidomos për sulmin e grave kundër xhandarëve, që kishte ndodhur në fillim të vitit 1925, ai na fliste gjithnjë me admirim. Unë i mbaj mend mirë fjalët dhe veprimet e tij, sepse ne të dy nuk ishim vetëm moshatarë, por edhe fqinjë. Shtëpitë tona i ndante vetëm një përrua i vogël, që në fshat quhet përroi i Dokos.»

Faktet dhe shokët e tij tregojnë se, kur u largua nga vendlindja për të gjetur një punë, Thanasi nuk kishte marrë me vete vetëm një bohçe me sende të nevojës së parë, por edhe shumë kujtime të shtrenj-

ta, që kishin qenë për të mësimë shumë të vyerë në çdo hap të jetës...

Gjatë atyre ditëve që qëndroi në Gjirokastrë në mbrëmje mblidhej shpejt në dhomën e vogël të hanit të vjetër. Atje s'kishte ç'të bënte, se nuk njihej me njeri që të bisedonte. Posa shtrihej në shtrat, ai sillte ndër mend vozaxhinjtë që kallëzonin se si niseshin me maraz në zemër për në vendet e largëta. Edhe vetë Thanasi ishte nisur nga shtëpia për të kërkuar punë. Vozaxhiu kishte të paktën një sqepar në brez e në zdruk në shpinë, si dëshmitarë të zanatit që ushtronte. Ndërsa ai jo vetëm që s'dinte asnjë zanat, por s'kishte as përvojë nga jeta. Sot ndodhej në Gjirokastrë, nesër pasnesër do të ishte në Tiranë. Thanasi e kuptonte se në këtë mes kishte ndryshuar vetëm ana e jashtme, ndërsa thelbi kishte mbetur po ai që kishte qenë edhe në kohën e vozaxhinjve, edhe në kohën e kurbetçinjve. Shoqëria nuk u siguronte të rinjve gjënë më të thjeshtë e më të nevojshme: punën për të jetuar. Që nga dita kur kishte mbaruar shkollën fillore, ai kishte jetuar në fshat si njeri i papunë, si njeri i tepërt, si të thuash, ashtu siç kishte mbetur edhe i ati në Amerikën e largët. Ç'ngjashmëri!

«Pse ndodh kështu? Pse?» pyeste veten plot ankth djaloshi nga Sopiku i Pogonit. Por përgjegje s'mund të gjente kurrkund. Oh, sa pikëpyetje të reja i lindnin atij në shpirt çdo ditë e çdo orë! Sa gjëra të panjohura i dilnin përpara! Do të gjente vallë një zgjidhje të kënaqshme? Kush do t'ja jepte atij përgjegjen e drejtë e të saktë për gjithë këto gjëra të panjohura që i dilnin në çdo hap që bënte në rrugët plot kthesa të jetës?

## PËR BUKËN E GOJËS

Pas një udhëtimit të gjatë në rrugë të ngushta e të pashtruara, në të cilat lëviznin më shumë qerre se sa maqina, kamioni mbërriti në Tiranë. Thanasi u hodh menjëherë nga karrocera, shkundi pluhurin e rrugës dhe me bohçen në dorë u fut në mes të njerëzve. Sa të vetmuar e ndjente veten në këtë çast! Për ku ishte nisur? Ku do të shkonte? Kush do ta priste në këtë qytet, që mund të mos ishte tepër i madh, por atij që vinte nga fshati i dukej sa një botë e tërë?

Rrugës ai herë-herë qëndronte pak për të lexuar tabelat e dyqaneve e për të vështruar vitrinat. Pাপritmas, një djalosh pak a shumë në moshën e tij, por i zbathur e i veshur me zhele ju afrua dhe i thirri:

— A nuk ma jep mua bohçen të ta çoj në hotel?

— S'ka nevojë, e çoj vetë, — ju përgjegj i por-saardhuri. — Po, a ka këtu afër ndonjë hotel?

— Hotel të mirë do ti, apo...

— Hotel të lirë...

Vitin që Thanasi u largua nga fshati për në Tiranë, aty nga fundi i vitit 1929, në botën kapitaliste



plasi një krizë e madhe ekonomike. Ekonomia e vendeve më të zhvilluara e më të fuqishme kapitaliste u godit rëndë. Kjo valë e re krize, papunësie dhe varfërie në shkallë botërore s'kishte si të mos ndikonte edhe në ekonominë e dobët të vendit tonë, që ishte lidhur kokë e këmbë me ekonominë e Italisë fashiste.

Mbi gjendjen e Shqipërisë në atë kohë bën fjalë Ali Kelmendi në një raport që i dërgonte Internacionales Komuniste, ku thoshte midis të tjerave:

«Krizja ekonomike po bën kërdrinë me gjithë fuqinë e saj këtu në Shqipëri. Malësitë po kanosen drejtpërdrejt nga uria. Tregëtia ndodhet në një stagnacion të plotë. Numri i të papunëve po shtohet ditë për ditë. Banditizmi po ngrë përsëri krye...»

Në rrethana të tilla edhe Thanasi që vinte nga fshati i largët e kishte shumë vështirë për të gjetur një punë e për të siguruar bukën e gojës. Ndoshta kishte të drejtë e ëma që donte ta mbante në shtëpi. Por tani vendimi ishte marrë. Ai do të bënte çmos që të shkonte medoemos përpara e në asnjë mënyrë nuk do të kthehej mbrapsht.

Natën e parë siguroi një dhomë me dysheme prej dërrasash e me tavan të ulët në një hotel të lirë, ku vendosi edhe plaçkat që kishte sjellë nga shtëpia. Për një kohë qëndroi pranë dritares së hapur me shpresë se mund të shihte ndonjë bashkëfshatar që punonte në Tiranë. Shpresë e kotë! Njerëzit kalonin me nxitim, të kërrusur nga hallet e jetës. Më në fund hapi bohçen e nxori kulaçin që i kishte vënë e ëma si dhe një copë djathë bërë thërri-me-thërrime. Kjo ishte darka e tij e parë në kryeqytet...

Pastaj mori një copë letër e një laps e nisi të shkruante:

E dashur nënë,

Sot mbërrita në Tiranë dhe po të shkruaj menjëherë. Rruga që e gjatë dhe e lodhshme, por unë e ndjej veten mirë. Mos ki fare merak për mua...

«Çfarë t'i shkruaj më? — tha me vete. — Më mirë ta mbaj letrën në xhep gjersa të gjej ndonjë punë që ta marrë vesh dhe ajo e të gëzohet pak».

Në mëngjez ai u ngrit shpejt nga gjumi. Qyteti ende nuk që zgjuar. Ku do të trokiste tani për të kërkuar punë? Ju kujtua porosia e nënës që të takohej menjëherë me Mitron, me bashkëfshatarin e moshatarin e tij, që e kishte edhe kushëri të largët. Në fshat i kishin thënë se punonte në kuzhinën e një restoranti të vogël në periferi të qytetit. U vesh shpejt e shpejt e doli në rrugë. Duke pyetur njerëz të panjohur e gjeti më në fund restorantin që kërkonte. U takua me pronarin e lokalit.

— Ç'e ke ti Mitron? — e pyeti ai.

— E kam nga fshati, — ju përgjegj Thanasi.

— Eja më vonë. Mitrua tani është i zënë, — ja preu ai shkurt.

Më në fund Thanasi u takua me Mitron në një oborr të vogël prapa restorantit. Sa u gëzua Mitrua kur i doli përpara Thanasi, shoku i tij i ngushtë i fëmijnisë! Kishin tre vjet që s'ishin takuar. Gjatë kësaj kohe Thanasi kishte hedhur shtat dhe ishte bërë alamet djali. Edhe Mitroja që rritur mjaft.

— Thanas, ti këtu? — u habit Mitrua.

— Ndoqa rrugën tënde, Mitro, ndonëse me vonesë. . . .

— Pse kështu, Thanas?

— Ende nuk po e merr me mend? Ja, për të gjetur ndonjë punë. . .

— Ashtu?! . Mirë, pa na thuaj njëherë ç'kemi nga fshati, pa për punën flasim më vonë.

Thanasi i foli gjerë e gjatë Mitros për të rejat e fshatit. Tjetri dëgjonte me vëmendje. Kur Thanasi i dha fund kallëzimit, shoku i tij i fëmijnisë e pyeti si me ngurim:

— Domethënë, Thanas, edhe ti për punë ke ardhur këtu?

— Afër mëndjes.

Midis dy shokëve ra një heshtje e rëndë dhe e mërzitshme.

— Si thua ti, Mitro, nuk do të gjej gjëkund i ndonjë punë? — e nisi përsëri bisedën Thanasi.

— Vështirë është, Thanas. Nuk e merr dot me mend sa vështirë është. Edhe unë mezi e gjeta këtë copë punë në këtë lokal të vogël.

— Unë bëj çdo punë që të jetë, Mitro. . .

— E kuptoj, e kuptoj, o Thanas. Po është hall i madh. Megjithatë, ti mos u dëshpëro. Do të bëjmë çmos. Kalo çdo ditë këtej nga unë. Tani më vajti ora për punë, ika, — përfundoi Mitroja dhe u ngrit nga vendi. Por, pasi bëri nja dy hapa, u kthye nga shoku dhe i tha:

— S'të pyeta, Thanas! Ku fle ti?

— Në një si hotel a si han, si të duash mund ta marrësh.

— Nga bie ky hani yt?

— Hani im? Andej, prapa bulevardit të madh. Se mos i di mirë unë rrugët e Tiranës!

— Ë di ku e kam fjalën, o vëlla! Ke sjellë ndo-një mbulesë me vete?

— Posi, ore! Kam një velenxë aq të trashë, sa kur mbulohesh me të mund të djersitësh edhe në janar.

— Shumë mirë, shumë mirë. Unë kam një dhomë me qira sa për të futur kokën. Një karakatinë është, por ka një të mirë, se është shtruar me dërrasa. Kështu që mund të flemë të dy mbi dysHEME dhe do t'i ndajmë edhe hallet së bashku. . . Më kupon? Po të duash, merri plaçkat e tua dhe hajde nesër pasdite këtu. Tani, mirë u pafshim!

Thanasi mori rrugën e kthimit drejt hotelit, duke thënë me vete: «Po të mos kishte ngulur këmbë nëna, do të kisha ardhur vetëm me një bohçe në dorë dhe pa asnjë mbulesë. Dhe ata pak lekë që kam në xhep, do t'i harxhoja për hotel. Eh, moj nënë! Sa të drejtë ke patur ti që ngule këmbë atë ditë që do të nisesha, për të marrë me vete edhe një velenxë!»

Ditën tjetër ai u vendos në dhomën e Mitros. Atje s'kishte as shtretër, as tavolinë, as karrige. Dhoma ishte e vogël, me një dritare nga ana e një rrugice të ngushtë e të zyrtë me disa shtëpi të vjetra prej qerpiçi. Gjysma e xhameve të dritares ishin thyer dhe në vend të tyre ishin vendosur copa katrore kartoni. Që të ngjiteshe në katin e dytë ku gjendej dhoma, duhej të kaloje nga një shkallë e ngushtë dhe e fëlliqur që, sa herë hipnin e zbrisnin njerëz, kërciste me të madhe sikur do të rrëzohej.

Mëngjezin e ditës tjetër të dy bashkëfshatarët filluan të kërkonin ndonjë punë. Por ngado që shkonin e kudo që pyesnin merrnin të njëjtën përgjegje.

Asnjë nuk kishte nevojë për duart e këtij djaloshi të shëndoshë, që kishte ardhur nga fshati plot zell e vullnet për të punuar në çdo punë që mund të gjente.

Çdo ditë të dy shokët endeshin për të kërkuar punë. Kur afronte dreka, Thanasi e përcillte shokun gjer afër restorantit ku punonte. Pastaj mbetej vetëm e bridhte rrugëve të qytetit me një shpresë të fshehtë në zemër se do të dilte ndonjë njeri që do t'i thoshte: «Pa punë je ti djalosh? Eja të punosh te unë!». Por kudo nga hynte për të pyetur për punë, i përgjigjeshin ftohtë: «Jo, mor djalë, s'kemi punë për ty». Atëherë një revoltë e thellë ziente në shpirtin e tij dhe duart i mblihdeshin grusht në xhepe. Kundër kujt drejtohej kjo revoltë? As ai s'e dinte.

Gjatë këtyre shëtitjeve të detyruara nëpër rrugët e qytetit Thanasi i tërhiqnin vëmendjen shumë gjëra. Nëpër qoshet e rrugëve ai shihte kudo lypës të çdo moshe, që zgjatnin duart e rreshkura për të kërkuar lëmshë. Dhe djaloshit të ndijshëm i dukej sikur ai vetë ishte në vendin e këtyre lypësave. Ndodhte shpeshherë që aty pranë të kalonin me zhurmë pajtone luksoze me kuaj të ushqyer mirë e me lloj-lloj lulkash e salltanetesh. Në to Thanasi shquante disa njerëz trashalugë e të kënaqur nga jeta, që i vështronin me përçmim varfanjakët e rrugëve. Në dyqanet e rrugës «Mbretërore», që shisnin sende luksi, hynin e dilnin zonja të mëdha, rrobat prej mëndafshi të cilave fëshfërinin lehtë, sikur donin të tërhiqnin vëmendjen e kalimtarëve. Prapa tyre shkonin kokulur shërbëtorët me bohçe nën sqetull e me çanta të mbushura me sendet e blera...

Kur shihte këto gjëra, Thanasi ndjente një ankth

në kraharor, s'mund të qëndronte më në rrugë, prandaj, sikur ta ndiqte njeri, merrte rrugën me nxitim për në dhomë. Të pasur e të varfër kishte edhe në fashtin e tij të lindjes. Por këtu humnera që i ndante njerëzit midis tyre ishte aq e madhe sa që binte shumë në sy. Përshtypjet e ditës e ndiqnin djaloshin dhe kur hynte në dhomën e errët e të varfër të Mitros. Shoku i tij e mbaronte punën shumë vonë, kështu që Thanasi kalonte orë të tëra në vetmi.

Çdo ditë që kalonte i rëndonte më shumë në shpirtin e tij të shqetësuar. «Si do të bëhet puna ime? Gjer kur do të vazhdojë kështu?» — i vinte të thërriste me të madhe. Por ai e dinte që s'e dëgjonte njeri, prandaj heshte...

Një natë, ndërsa ishte duke pritur Mitron, mendoi: «Do të ishte mirë që sonte t'i jepja fund asaj letre për në shtëpi, që e kam filluar që ditën e parë që kam ardhur këtu». Pa u vonuar nxori nga xhepi letrën e zhubrosur e të zverdhur dhe mori lapsin në dorë. Shkarraviti disa fjalë në vazhdim të rreshtave që i kishte shkruar prej kohe. Por dorën sikur ja ndalte dikush dhe nuk i bëhej që të përfundonte letrën. «Po t'i shkruaj nënës që jam ende pa punë, ajo do të mërzitet më shumë e nuk do ta zërë gjumi gjithë natën. Po sikur t'i shkruaj se kam zënë punë? — thoshte me vete. Jo, jo, në asnjë mënyrë! Nënë e dashur! Unë e di se ti do të kesh mbetur duke pritur letër nga unë. Po ç'të të shkruaj, moj nënë? Që jam edhe sot e kësaj dite pa punë? A e mban mend ç'të thosha kur isha atje? Ç'të bëj këtu në fshat, — të thosha, — të vras mizat? Por edhe këtu, moj nënë,

njëlloj është si atje, në mos më keq. Unë ende s'kam gjetur punë dhe vras me të vërtetë miza. Ndaj nuk të kam shkruar gjer më sot. Të më falësh, nënë! Kur të gjej rast do të të kallëzohet çdo gjë me radhë e ti do të më japësh të drejtë... Po nuk e kam vetëm unë këtë hall. E keqja është e përgjithshme. Ngado që të hedhësh sytë shikon padrejtësi... Mitroja merr 75 lekë në muaj në restorantin ku punon dhe ha nga mbeturinat e gjellëve. «Të gjithë ne sa jemi atje punojmë për një njeri: për pronarin e lokalit», — thotë Mitrua i shkretë. Ja edhe një padrejtësi tjetër.»

Pa dashur vuri buzën në gaz. Ju kujtua një ngjarje e vogël në fshat. Kishin kaluar pesë-gjashtë vjet që atëhere, por ai nuk e harronte kurrë. Ndosh-ta sepse ishte hera e parë që kishte hasur në atë që njerëzit e quajnë padrejtësi. Në Sopik ishte një tregëtar, që e kishte dyqanin në mes të fshatit. Në atë dyqan mund të gjeje çdo gjë, madje dhe «qumësht dallëndysheje» — siç thoshte si me shaka dyqan-xhiu. Po fshatarët nuk kishin me se t'i blenin sendet që shiteshin atje. «Duhej të vrisje dhjetë veta, që të gjeje një njeri me lekë në xhep» — thoshin atëhere në fshat. Për të lehtësuar, gjoja, bashkëfshatarët e tij, tregëtari u jepte atyre sende me kredi, veresie. Por mjerë ai që regjistron në defteret e tregëtarit të Sopikut! Po të hyje një herë në ato deftere, nuk dilje më kurrë. Njerëzit thoshin si me shaka midis tyre: «Edhe po të kalosh në rrugë, tregëtari ynë të sheh dhe menjëherë të shënon në defter. Dhe borxhi fryhet e fryhet, saqë nuk shlyhet kurrë».

Një ditë Thanasi me të ëmën vajtën në dyqan

për të blerë një palë tiranta për pantallonat, që atë kohë përdoreshin në vend të rripit të mesit. Djali mori tirantat, ndërsa e ëma nxori nga xhepi lekët dhe pagoi. Këtë gjë Thanasi e pa mirë. Pas një farë kohe nënë e bir vajtën përsëri në dyqan për të blerë diçka tjetër. «Më ke edhe një palë tiranta për të paguar», — i tha tregëtari. «Unë sikur t'i kam paguar tirantat!» — ja ktheu e ëma. «Jo, zonjë, ç'është kjo që thua?» «Tirantat t'i kemi paguar që atë ditë» — u hodh me bindje Thanasi. «Jo, mor djalë i mirë, gabohe, unë i kam shënuar këtu në defter. Ja, shihe ti që di të lexosh!» — nguli këmbë tregëtari dhe i tregoi defterin e hapur. E ëma, që të mos bëhej ndonjë skandal përpara syve të botës, i pagoi për së dyti tirantat, ndërsa Thanasi nuk u përmbajt dot dhe thirri me të madhe në mes të dyqanit: «Kjo është vjedhje, kjo është padrejtësi!» Edhe kur u kthyen në shtëpi ai nuk pushonte së përsërituri: «Kjo është padrejtësi!». Dhe nuk gjente dot qetësi.

Por ç'ishte ajo padrejtësi e atëhershme në fshat, në krahasim me ato padrejtësi të mëdha që i dilnin tani në çdo hap në jetën e qytetit?

Hallet e jetës i kishin rënduar që në moshë të re në shpatullat e tij të njoma. Djemtë e pasanikëve, që ishin në një moshë me të, kërkonin vetëm si e si të bënin sa më shumë qejf. Ndërsa ai, si gjithë moshatarët e tij të vegjëlisë, përballonte për ditë vështirësi të reja, luftonte kundër tyre dhe dilte gjithnjë më i fortë. Ndoshta për këtë arsye ai pati një pjekuri të parakohshme për moshën që kishte. Vështirësitë dhe pengesat e kësaj faze qenë për atë ushtrime të përditshme, që i forcuan karakterin për të përballuar stuhitë më të egra dhe dallgët më të furishme,



që do të haste në periudhën e mëvonshme të jetës së tij.

Gjatë kohës që qëndroi në punë në Tiranë ai u njoh me shumë njerëz të zanateve të ndryshme, si kamerierë, banakierë, pjatararës, shërgertë dyqanesh, shërbëtorë nëpër familje të pasura si edhe me disa nëpunës të vegjël, të cilët hanin bukë në restorantin ku punonte Mitroja. Në përgjithësi ai njihej e miqësohej lehtë me njerëzit. E ën.a e Thanasit thotë për këtë veti të të birit: «Thanasi ishte i dashur me të gjithë, edhe në familje kur qemë së bashku me kunetërit, edhe në shkollë, edhe jashtë shkollës në fshat. Ai zinte miqësi edhe me mizat e dheut...»

Duke u njohur me njerëz të rinj, pak nga pak u zgjerua edhe rrethi i bisedave dhe i interesave të tij. Ndjaj mund të bënte krahasime dhe përgjithësimë më të drejta për fenomenet dhe problemet e jetës. «Familja është e shenjtë», — thoshte prifti në fshat. Këtë havaz e përsërisnin përditë edhe gazetatat që u hidhte nga një sy atje në lokal ku punonte Mitroja. Mirëpo faktet flisnin ndryshe. Dhe ai s'kish-te si të mos e vinte re këtë gjë. Mjaftonte që të merrte si shembull familjen e vet. Ajo ishte një familje e vogël prej tre vetash. Megjithatë, ishte një familje e shkoqur dhe e shpërndarë. «Ç'gënjeshtra!» thoshte me vete kur krahasonte fjalët që thuheshin me gjendjen e vërtetë. Po e vërteta ku fshihej? Dhe kush do t'ja tregonte atij? Kjo ishte diçka që i përkiste së ardhmes. Në atë kohë Thanasin e shqetëson-te më shumë se çdo gjë tjetër gjetja e punës.

Një ditë një nëpunës i vogël që punonte si ftues në gjyq dhe hante bukë në lokalin ku punonte Mitroja i tha:

— Thanas, Ministria e Drejtësisë shpall këto ditë një konkurs për shkrues e kopista gjyqi. A nuk merr pjesë edhe ti.

Djaloshi i papunë në fillim nuk tregoi ndonjë interes të veçantë për këtë konkurs. Ai kishte trokitur për punë në kaq dyer dhe asnjëra nuk i qe hapur, edhe kur ishte fjala për ndonjë ndihmëskamerier apo pjatalarës. Mirëpo Mitroja dhe shokët e tjerë, me të cilët qe njohur gjatë ditëve të fundit, e shtynë që të merrte pjesë në konkurs. «E vërteta është se ke shumë pak shanse për të fituar, se ti s'ke njerëz të të ndihmojnë dhe në punë të tilla bëhen dallavere të shumta. Por fundi i fundit s'ke për të humbur gjë. Ne të varfërit na duhet të trokasim në shumë dyer gjersa të na hapet një», — i tha një shok.

Në restorantin ku punonte Mitroja shkonte ngandongëherë mbrëmjeve edhe një sekretar gjyqi i Tiranës, i kaluar nga mosha. Thanasi gjeti rastin dhe e pyeti për punën e konkursit. Ai u mendua një herë dhe pastaj i tha: «Po të ishte për ndonjë nëpunësi tjetër, nuk do të këshilloja të merrje pjesë fare, se do të ishte një përpjekje e kotë. Por kur është fjala për kësi punësh të vogla, si për shkrues gjyqi, kopist e protokollist, edhe mund të fitosh, sepse djemtë e zengjinëve dhe të dyerve të mëdha nuk begendisin të futen në punë të tilla».

Pasi vendosi të merrte pjesë në konkursin e shpallur nga Ministria e Drejtësisë, Thanasi filloi të bënte një farë përgatitje, duke lexuar materiale të ndryshme dhe duke u konsultuar me njerëz që punonin nëpër gjykatat dhe zyrat e prokurorisë së asaj kohe. Në shkollën fillore ai kishte qenë nxënës i

shkëlqyer. Edhe pasi kishte mbaruar shkollën e fshatit, nuk kishte hequr dorë nga librat. Etja e tij për të mësuar ishte aq e madhe, saqë lexonte çdo libër që i binte në dorë, edhe sikur ky libër të mos i përshtatej moshës dhe nivelit të tij. Shkolla e jetës së përditshme i kishte mësuar atij shumë gjëra të reja.

Thanasi e dinte se shumë nga pjesëmarrësit në konkurs do të kishin rekomandime nga njerëz me influencë, ose njohje personale a familjare me njerëz të rretheve të larta të Ministrisë së Drejtësisë, të cilët kishin në dorë kyçet e këtij sektori. Ndërsa ai s'kishte asgjë tjetër përveç përgatitjes dhe vendosmërisë së papërkulshme që të luftonte e të mos zbrapset përpara asnjë pengese.

Duhet shtuar se Thanasi shkruante shumë shpejt e qartë, cilësi kjo e domosdoshme për një shkruar gjyqi, i cili do të mbante procesverbalet e seancave gjyqësore dhe të mbledhjeve të ndryshme. Ndoshta kjo cilësi e fundit ndikoi më shumë se çdo gjë tjetër që Thanasi të ishte në listën e atyre që fituan në konkurs. Disa ditë pas konkursit u emërua si kopist-protokollist në gjykatën e shkallës II të nënprefekturës së Krujës. Që nga ajo kohë në jetën e djaloshit nga Sopiku i Pogonit filloi një fazë e re: ajo e nëpunësit të ulët në administratën e regjimit të Zogut

## «NE JEMI SHUMË, MOJ NËNË!»

Atë ditë që ju komunikua emërimi në gjykatën e nënprefekturës së Krujës, Thanasi i nisi një letër nënës në fshat. Letra e parë, e filluar prej ditësh, që zverdhur e zhubravitur në xhep si mos më keq. Ndaj e grisi dhe shkroi një letër tjetër të gjatë e me plot hollësira për jetën e tij në Tiranë dhe punën e re që do të fillonte. Pas disa ditësh kjo letër e shkruar nga dora e të birit hodhi një rreze drite në atë shtëpi të vogël të fshatit Sopik dhe ndezi një shpresë të re në shpirtin e nënës së shumëvuaajtur.

Letra ishte mjaft optimiste për të ardhmen. Si duket, Thanasi, ditët e para pas emërimit të tij si kopist-protokollist gjyqi, ushqente shumë iluzione për jetën e tij në të ardhmen.

Ishte koha e krizës së madhe ekonomike, kur njerëzit endeshin poshtë e lart pa punë dhe ata që bënë punë të vështira krahu merrnin një mëditje qesharake. Prandaj sigurimi i një nëpunësie, sado të vogël, në aparatën qeveritar, konsiderohej një gjë e madhe dhe gati-gati një privilegj. Thanasi kishte një vend pune pa telashe të mëdha në zyrat e qeverisë dhe një rrogë, ndonëse të ulët, por të sigu-

ruar. Detyrime familjare të mëdha nuk kishte, siç ndodhte me shumë moshatarë të tij nga fshati. E ëma me punën e saj të përditshme e siguronte vetë jetesën. Sa herë i biri i dërgonte asaj të holla ose sende të tjera, ajo i shkruante të shikonte shëndetin, të vishej e të mbathej mirë dhe të mos harxhohej për atë, se ajo nuk kishte ndonjë nevojë të madhe për ndihmat e tij.

Mund të pritej, pra, që shpirti i revoltuar i Thanasit nga vuajtjet e para në jetën e pavarur do të gjente më në fund qetësi e vetëkënaqësi dhe, si rrjedhim, ai do të pajtohej plotësisht me gjendjen dhe regjimin e asaj kohe. Por ndodhi krejt e kundërta. Karriera e tij tetëvjeçare si nëpunës gjyqi nuk karakterizohet aspak nga një jetë e rehatshme, por nga përpjekje të vazhdueshme për të hyrë sa më thellë në problemet e mëdha të shoqërisë shqiptare të asaj kohe për t'u lidhur sa më ngushtë me elementë përparimtarë dhe me komunistë të grupeve komuniste që vepronin në vitet 30 në qendrat e ndryshme të vendit.

Në fillim ai punoi për disa muaj si praktikant pranë gjykatës së Tiranës. Pasi fitoi një farë përvojë në administratën shtetërore dhe në punën e gjyqeve, u vendos në Krujë, ku filloi punën si kopist-protokollist në gjykatën e shkallës II të këtij qyteti.

Nuk gjenden dokumenta të shkruara për punën e Thanasit në Krujë dhe për aktivitetin e tij shoqëror në këtë rreth. Por shokët që e kanë njohur atë në fillim të viteve 30 flasin për një të ri entuziazt, optimist, për një njeri që lidhej lehtë me punonjësit dhe mendohej gjithnjë të mësonte nga ata që dinin më shumë se ai.

Puna në gjykatë i jepte atij përditë raste interesante dhe materiale të bollshme për të njohur më mirë jetën e për të parë më nga afër padrejtësinë që sundonte kudo në pushtetin antipopullor të Ahmet Zogut. Pra, gjyqet, ku pasqyrohen shumë anë të jetës së një populli dhe duket qartë karakteri i vërtetë i një regjimi politik e shoqëror, kanë qenë një shkollë tjetër e madhe për Thanas Zikon. Duke qenë në kontakt të përditshëm me popullin, mendja e tij e hollë zbulonte, nën maskën e formulave dhe procedurave juridike, realitetin politik e shoqëror të Shqipërisë të asaj kohe. Vendimet e pa drejta që merreshin nga gjykatat e shkallëve të ndryshme në kurriz të popullit fukara nuk mund ta linin indiferent këtë djalë të vegjëlisë. Atij i dhimbseshin me të vërtetë njerëzit e popullit, që trokisnin në dyert e gjykatave me shpresë se do të gjenin drejtësi. ndërsa në fakt gjenin të kundërtën. Kur merreshin vendime të padrejta nga gjykatat në kurriz të popullit punonjës e në dobi të klasave në fuqi, ky kopist i thjeshtë i aparatit gjyqësor pyeste veten: «Gjykatat janë organe për t'i dhënë drejtësi popullit ashtu si reklamohen, apo për të vulosur padrejtësinë flagrante, që kryejnë me të dyja duart ata që kanë fuqinë në dorë?»

Sigurisht ai ishte ende shumë larg të vërtetës së madhe të jetës e të shoqërisë. Dita që ai do binte në kontakt me idetë e mëdha të marksizëm-leninizmit do të vinte më vonë. Vetëm një gjë ishte pozitive dhe që premtonte shumë: Thanasi ishte vënë në rrugën e kërkimit të së vërtetës, ai ishte vënë në lëvizje për të zbuluar shkaqet e padrejtësive shoqërore dhe të vendimeve të padrejta që jepeshin nga

gjykatat, të cilat i shërbenin me besnikëri feudo-borgjezisë.

Kjo rrugë e kërkimit e vuri atë në kontakt me elementë përparimtarë, me njerëz që ishin nën ndikimin e ideve komuniste. Njohja e Thanasit me elementë komunistë të kohës filloi që nga kjo periudhë e punës së tij në Krujë. Në këtë qytet të vogël, siç i raportonte Ali Kelmendi Kominternit, vepronte në atë kohë një grup komunist «që përbehej nga nëpunës e mësues». Në një blok të vogël xhepi të Thanasit, që është sekuestruar më vonë nga xhandarmëria e Zogut e që tani ndodhet në arkivin e shtetit, gjejmë disa shënime shumë të shkurtëra, por që paraqesin një interes të veçantë për jetën dhe aktivitetin e tij në këtë kohë. Në një faqe të këtij bloku Thanasi ka shkruar me dorën e vet: «Pasnesër në orën pesë pasdite kam takim me Mustafa Kaçaçin»<sup>1)</sup>. «Të dielën vajta në Mamuras për t'u takuar me shokun M».

Siç del edhe nga shumë burime të tjera, rrethi i miqve dhe i shokëve të Thanasit zgjerohej nga dita në ditë gjithnjë e më tepër. Ai u bë shpejt i dashur me njerëzit me të cilët vinte në kontakt dhe me përzemërsinë e singëritetin e tij të natyrshëm u fitonte zemrën miqve të rinj. Por ai nuk harronte aspak shokët e fëmijnisë dhe miqtë e vjetër. Përkundrazi, Thanasi mbante lidhje me ta dhe tregonte një interesim të vazhdueshëm për gjendjen dhe për fatin e bashkëfshatarëve të tij. Për këtë

---

1) Mustafa Kaçaçi — komunist i vjetër nga Kruja, i vrarë gjatë Luftës nacionalçlirimtare.

flasin shumë nga shokët e tij të fëmijnisë dhe të rinisë së parë në fshat.

Kristo Çevi, bashkëfshatar dhe pak a shumë mo-shatar i Thanasit, lidhur me këtë tregon:

«Unë kam qenë bashkë me Thanas Zikon në shkollën fillore të fshatit. Ai ka qenë një klasë më poshtë se unë, por kjo s'na pengonte të ishim miq e shokë të ngushtë. Edhe më vonë, pasi mbaruam shkollën fillore, miqësinë tonë e mbajtëm gjithnjë të ngrohtë e të fortë. Thanasi mbeti për një kohë në fshat, sepse s'pati mundësi të vazhdonte shkollën e mesme, me gjithë dëshirën e madhe që kishte për të. Në verë, kur ne që vazhdonim shkollën ktheheshim në fshat për pushime, shoqëroheshim çdo ditë me Thanasin, organizonim ekskursionë të gjata, dilnim për gjah, bisedonim me njerëzit për problemet dhe hallet e tyre. Thanasi kishte një cilësi të rrallë: ishte gjithnjë i dashur dhe i përzemërt me njerëzit që kishte pranë. Më vonë, kur ai u largua nga fshati dhe zuri punë si shkruer gjyqi, i vajta një herë në Krujë. Bashkë me mua ishte edhe një bashkëfshatar tjetër, i cili kishte një hall familjar dhe kërkonte ndihmën e Thanasit. Kishim nja dy vjet që s'ishim takuar. Ashtu siç e prisnim, ai u tregua i dashur, i përzemërt me ne, dhe tregoi interesim të veçantë për çështjen e bashkëfshatarit tonë. Sa qëqëndruam në Krujë, Thanasi nuk na u nda për asnjë çast. Ai kështu i priste të gjithë ata që vinin nga fshati, madje të gjithë thoshin se ai mundohej t'i ndihmonte me çdo gjë që kishte në dorë».

Gjithë këto lëvizje e takime të Thanasit me njerëz të kategorive të ndryshme nuk ishte e mun-



dur të mos shiheshin me sy të keq nga ana e autoriteteve të regjimit zogist. Për autoritetet e asaj kohe, nëpunës i mirë ishte ai që mbyllej në zyrë, merrej gjithë ditën me shkresa dhe nuk çante kokën aspak për ato që ndodhnin rreth e rrotull.

Prandaj, me qëllim që ta shkëpusnin atë nga rrethi i shokëve që kishte krijuar në Krujë e në Tiranë, ku shkonte shpesh, autoritetet zogiste, pa mbushur ende dy vjet shërbim në këtë qytet, e transferuan si kopist-protokollist në gjykatën e Pogradecit dhe që andej në atë të Korçës.

Qëndrimi i tij qoftë edhe për një kohë të shkurtër në Korçë, që ishte një nga qendrat kryesore të lëvizjes komuniste në vend, ka ndikuar në aktivitetin revolucionar të mëvonshëm të Thanasit. Kjo kohë mund të quhet fare mirë si periudha përgatitore për revolucionarin e ardhshëm. Në Korçë Thanasi u njoh më mirë me problemet e jetës dhe krijoi lidhjet e para me njerëzit e lëvizjes revolucionare komuniste në Shqipëri. Në Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë, lidhur me periudhën e fundit të viteve 20 dhe fillimet e viteve 30, thuhet: «Më 1928, elementë të përpëruar, punëtorë e zejtarë, krijuan në Korçë celulën e parë komuniste... Brenda një kohe të shkurtër në Korçë u krijuan edhe celula të tjera. Kjo e bëri të nevojshme riorganizimin e punës. Për këtë qëllim, në qershor të vitit 1929 u mbajt mbledhja e përfaqësuesve të celulave komuniste... *Mbledhja e qershorit 1929 shënon krijimin e Grupit Komunist të Korçës dhe fillimin e lëvizjes së organizuar komuniste...* Grupi komunist i Korçës ishte e para organizatë politike revolucionare e klasës punëtoare shqiptare...»

Duke punuar në një ambient të tillë, Thanasi u vu në kontakt me elementë përparimtarë, që kishin lidhje me Grupin Komunist të Korçës. Ai e kuptonte çdo ditë më mirë se nuk ishte e mjaftueshme të ushqeje ide përparimtare e të flisje poshtë e lart kundër regjimit të Zogut. Kishte ardhur koha që njerëzit, të cilëve u dhimbsej populli dhe atdheu, të bashkonin forcat dhe t'i shkrinin ato në një organizatë të vetme. Por tamam në kohën kur ai krijonte lidhjet e para me elementë të Grupit të Korçës i erdhi transferimi i tretë, këtë radhë për në Kukës. S'kishte asnjë dyshim se edhe ky transferim nuk ishte bërë pa qëllim nga ana e autoriteteve, të cilët kërkonin të veçonin Thanasin nga rrethi i gjerë i shokëve, duke e dërguar në një rreth të largët, ku në atë kohë s'kishte lëvizje komuniste të organizuar.

Ndërkohë edhe në jetën vetiake e familjare të Thanasit kishin ndodhur disa ndryshime që vlejné të përmenden.

Në verën e vitit 1931 ai shkoi për dy-tri javë me leje në vendlindje. Fshatin e tij të dashur e gjeti më të varfër e më të braktisur nga ç'e kishte lënë dhe gjendjen e familjes më të mjeruar. E ëma, për të mbajtur «shtëpinë e hapur», siç thoshte vetë, luftonte me mish e me shpirt dimër e verë në atë copë vreshtë, që ishte për të i vetmi burim me të cilin mbante frymën gjallë. Që nga dita kur ishte larguar Thanasi nga fshati, shtëpia kishte mbetur e shkretë. Kthimi i të birit, megjithëse për pak kohë, e mbushi shtëpinë me gëzim e gjallëri. E ëma kishte kohë që e priste me padurim këtë ditë. Madje kishte bërë

edhe një plan për të birin: ajo do të bënte çmos që të martonte Thanasin gjatë kohës që ai do të qëndronte në fshat. I kishte gjetur edhe nusen. Mirëpo Thanasi nuk donte të pranonte një plan të tillë të përgatitur me aq kujdes nga nëna. Ai ishte atëherë 21 vjeç. Kur kishte marrë rrugën për në fshat, as që kishte menduar të martohej në atë kohë. E ëma, gjyshi plak dhe të afërmit e tjerë e shtynë Thanasin që t'u plotësonte këtë kërkesë. Ja ç'tregon nëna për këtë çështje: «I pari i foli për martesë gjyshi, im vjehërr. Ai ato ditë ishte në dyshek e gati për të dhënë shpirt. Disa herë me radhë u mundova edhe unë t'i mbushja mendjen të martohej. Pastaj i folën të afërmit e tjerë. Mirëpo ai nuk kandisej. Ishte hera e parë që Thanasi më kundërshtonte hapur. Një natë ju afrova me lot në sy dhe i thashë: «Thanas, përsëri vetë do të më lësh mua? Mjaft jetova pa njerëz tamam si qyqe, mor bir, në këtë shtëpi që kanë ditë e natë për njerëz. Po të ikësh pa u martuar, unë do të vdes nga marrazi! Dhe shtëpia e Zikojve që kanë qenë e nderuar nga të gjithë këtu në fshatin tonë, do të mbyllet njëherë e përgjithmonë». Pata ndër mend t'i flisja edhe më dhe t'i thosha të gjitha ato që më zienin në kraharor. Por nuk e di se si u ngashëreva e s'mund ta zgjasja më tepër. Djali im i mirë, Thanasi i urtë dhe i dëgjueshëm, u prek shumë nga lotët që binin pa pushim nga sytë e mi. Atë çast nuk më tha gjë. Pas pak më përqafoi me mall, ashtu siç bënte kur ishte i vogël, dhe më pëshpëriti në vesh: «Nënë, a nuk e lëmë gjer nesër këtë punë? Të mendohej edhe unë një herë, sepse gjer tani më dukej si shaka. . .»

Të nesërmen unë nuk vajta në punë. Tek ga-

tuaja mëngjezin, ai m'u afrua e më tha: «Për hatrinë tënd, moj nënë, e për hatrinë e gjyshit, që është në ditët e fundit mora një vendim që më duket i parakohshëm. Por hajde tani, të dalë për hajr!». »

Unë e përqafova me mall dhe që atë ditë ju përvesha punës për të përgatitur dasmën».

Ishte gushti i vitit 1931 kur Thanasi u martua me Avjerini Mezinin, një vajzë e urtë e punëtore po nga fshati Sopik. Pas një viti atyre u lindi vajza e vetme, së cilës i vunë emrin Persefoni. E shoqja, Avjerini, mbeti gjithnjë në fshat dhe së bashku me të vjehrrën merrej me punët e bujqësisë e me rritjen e vajzës.

Kështu, Thanasi u bë kryefamiljar. Nga sa thonë shokët e tij më të ngushtë të asaj periudhe, ai kishte menduar disa herë që ta merrte familjen me vete në qytet. Po ku ta çonte? Shtëpi nuk kishite dhe të ardhurat e tij ishin fare të pakta. Përveç kësaj, nuk e linin të qetë as transferimet. Pa u vendosur mirë në një vend, atë e lëviznin për në një vend tjetër. Aty nga fillimi i vitit 1934 ju komunikua transferimi nga Kukësi për në Tiranë, po me atë detyrë që kishte patur edhe më parë. Atë kohë kriza e madhe ekonomike vazhdonte të trondiste nga themeli gjithë botën kapitaliste. Rrjedhimet e kësaj krize të thellë ndjeheshin gjithnjë e më fort dhe në Shqipërinë e prapambetur e të shfrytëzuar në mënyrë të egër nga kapitali i huaj e nga feudoborgjezia e vendit. Ky keqësim i përgjithshëm i gjendjes ekonomike të vendit dhe zia e bukës që kishte pllakosur shtresat e varfëra e thelluan edhe më shumë pakënaqësinë e popullit punonjës ndaj regjimit reaksionar të zogut. Në këto vite të krizës së për-

gjithshme lëvizja e forcave demokratike në Shqipëri po gjallërohej më shumë, dhe përhapja e ideve përparimtare komuniste po merrte përditë përpjesëtime më të gjera.

Thanas Zijoka në këtë kohë e kishte njohur mirë shoqërinë dhe kishte fituar një përvojë më të madhe nga jeta.

Menjëherë pas transferimit në Tiranë ai krijoi lidhje me elementët përparimtarë të kryeqytetit dhe filloi të zhvillonte një aktivitet konkret revolucionar. Ai merrej me përhapjen e letërsisë marksiste që kishte filluar të qarkullonte në atë kohë në rrethet e punëtorëve, zejtarëve dhe të intelektualëve. Nihat Lekdushi, që atë kohë punonte me Thanasin në prokurorinë e qarkut të Tiranës, tregon:

«Thanas Zikon e kam njohur në fillim të vitit 1934, kur e transferuan nga Kukësi në kryeqytet si kopist-protokollist në zyrat e prokurorisë së qarkut të Tiranës. Meqë punuam së bashku në një zyrë e për një kohë jo të shkurtër, ne u miqësuan shumë me njëri-tjetrin. Ai ishte një tip i afruar me një-rëzit, i përzemërt me shokët dhe për shoqërinë jep-te çdo gjë. Nga sa më thoshte vetë Thanasi, atë e kishin transferuar nga Jugu në Veri, në Kukës, si dënim, meqë në Korçë kishte patur kontakte të vazhdueshme me njerëz përparimtarë që shiheshin me sy të keq nga organet qeveritare. Që nga dita kur kishte hyrë si nëpunës i vogël në organet e drejtësisë, s'kishte gjetur asnjëherë qetësi. Gjatë kohës së qëndrimit të tij në Tiranë Thanasi flinte në dhomën e një bashkëfshatari. Kur ne, shokët e tij më të ngushtë, e pyesnim përse nuk zinte ndonjë dhomë me qira, na përgjigjej si me shaka, por në fakt

thoshte të vërtetën: «Ku të lënë këta derra të qeverisë në një vend! Sa të njihesh mirë në një qytet e të krijosh një shoqëri për të qenë, ata të japin një shqelm e të degdisin prapa diellit, atje ku u leverdis atyre më shumë. Këtë gjë unë e kam provuar mbi kurrizin tim disa herë me radhë...»

— Mbaj mend mirë, — vazhdon shoku i tij i zyrës Nihat Lekdushi, — se gjatë atij viti që Thanasi ishte në Tiranë kishte filluar të botohej «Nëna» e Maksim Gorkit. Libri dilte në fashikuj të veçantë, kështu që botimi vazhdoi për një kohë të gjatë. Thanasi jo vetëm që i lexonte nga të parët fashikujt që dilnin në qarkullim, por bënte çmos që t'i përhapte sa më shumë në radhët e kolegëve dhe të njohurve të tjerë... Atë kohë që punonte në Tiranë Thanasi nuk ishte ende i organizuar në ndonjë nga grupet komuniste që vepronin atëhere edhe në kryeqytet. Por ishte më se e qartë se ai shpejt ose vonë do të hynte në këtë rrugë. Kur bisedonim për hallet e popullit dhe për rreziqet që i kanoseshin vendit tonë, Thanasi thoshte: «Shpresa jonë e vetme është Stalini. Ai është mbështetje e sigurtë jo vetëm për ne, por për gjithë popujt që luftojnë për liri... Të gjitha këto veprime të Thanasit s'ishte e mundur të mos binin në sy të autoriteteve zogiste. Pa kaluar shumë kohë atij i komunikuan transferimin në Berat. Thanasi s'kishte mbushur as dy vjet në Tiranë. S'kishte dyshim se edhe ky transferim i fundit bëhej me qëllim. Autoritetet reaksionare nuk donin që ai të jetonte në rrethin e miqve e shokëve të tij. Për t'i hedhur hi syve, atë e transferuan atje gjoja me gradim, duke e caktuar në vendin e sekretarit të gjy-

katës së shkallës I të qarkut të Beratit. Por Thanasi e kishte nuhatur ku e kishin ata hallin. Ditën që u ndamë më tha: «Desha t'u jepja të kuptonin atyre të Ministrisë së Drejtësisë që më komunikuan transferimin se ne nuk hamë kashtë, ashtu si kuptojnë ata, por përkundrazi, jemi fare mirë në gjendje të dallojmë prapa fjalëve të bukura planet e tyre djallëzore. Por mendova se do të ishte më mirë që këtë t'ua tregoja me vepra e jo me fjalë, sepse, i dashur, ka ardhur koha për vepra konkrete. Besoj se më kupton ku e kam fjalën». Pas disa ditësh ai u largua nga Tirana dhe paskëtaj ne takoheshim shumë rrallë...»

Berati ishte qyteti i fundit i Shqipërisë, ku Thanasi jetoi e veproi para se të arratisej jashtë shtetit. Tanimë ai kishte mbushur 26 vjeç. Pra, kishin kaluar gjashtë vjet që prej asaj kohe kur ky çunak me vullnet të fortë, por pa përvojë në jetë, ishte nisur një ditë vjeshte nga një fshat i largët i Pogonit. Sa ndryshime kishin ndodhur gjatë kësaj kohe në shpirtin e Thanasit! Ai kishte jetuar e punuar në shumë qytete, si në Jug ashtu dhe në Veri të Shqipërisë, dhe kudo ai kishte vënë re një gjë të përbashkët: varfëri, shfrytëzim, amulli, por edhe revoltë të ndrydhur në shpirtrat e njerëzve. Djaloshi që vinte nga Pogoni i largët kishte lindur dhe ishte rritur në gjirin e vegjëlisë, prandaj ishte dhe shumë i ndijshëm ndaj vuajtjeve të saj. Thanasi mund të mos kuptonte ende shumë gjëra nga jeta e shoqërisë, por ankthin e punonjësve dhe oshëtimën e largët të revoltës së madhe, që po afrohej gjithnjë më tepër, ai e ndjente çdo ditë më qartë. Pikërisht në këtë kohë ai filloi të nxirrte konkluzionet e para jo vetëm për shoqërinë, në përgjithësi, por edhe për de-

tyrat konkrete që u dilnin të rinjve të asaj kohe për të përmbysur atë gjendje të padurueshme.

Është e vërtetë se Thanasi ende nuk ishte i organizuar në ndonjë organizatë përparimtare. Ai edhe kur shpërndante fashikujt e romanit «Nëna» të shkrimtarit të madh proletar, edhe kur fliste me entuziazëm dhe admirim për vendin e parë të socializmit në botë, duhet pohuar se vepronte në mënyrë spontane. Po tani ai ishte i përgatitur nga çdo pikëpamje që përpjekjet e tij të paorganizuara e të pakoordinuara t'i kanalizonte në shtratin e përbashkët të pakënaqësisë popullore kundër regjimit shtypës dhe t'i bashkonte me luftën dhe përpjekjet e rretheve përparimtare, që në atë kohë kishin filluar të viheshin në lëvizje.

Berati i mesit të viteve tridhjetë ishte një qytet i vogël krahinor, pa industri dhe pa klasë punëtore të zhvilluar. Por në afërsi të këtij qyteti ndodhej Kuçova (sot qyteti Stalin), qendra më e rëndësishme industriale e Shqipërisë në atë kohë, ku ishin përqëndruar disa qindra naftëtarë e punëtorë të shërbimeve ndihmëse. Që të gjithë ata shfrytëzoheshin egërsisht nga shoqëria italiane, e cila kishte marrë si koncesion nga qeveria e Tiranës shfrytëzimin e zonave naftëmbajtëse të Shqipërisë. Me iniciativën e komunistëve, në Kuçovën e atëhershme u formuan shoqëri punëtorësh, të cilat organizuan greva të mëdha. Këto greva masive tregonin se në Shqipëri diçka po lëvizte, dhe një klasë e re, e vogël në numër, por e vendosur e kompakte, po hynte në arenën e madhe të luftës së klasave. Kjo klasë e re tani e tutje do të merrte drejtimin e luftës së shtresave e klasave të shfrytëzuara kundër shfrytëzuesve.



Greva e madhe dhe manifestimet e tjera të punëtorëve të naftës në fund të vitit 1935 dhe në fillim të vitit 1936 tërhoqën vëmendjen e gjithë njerëzve përparimtarë në të katër anët e Shqipërisë. Pa dyshim, ajo ndikoi edhe në shpirtin e Thanas Zikos, që në këtë kohë punonte në atë qark dhe ndiqte me interesim çdo ngjarje e çdo veprim që drejtohej kundër regjimit tiranik në fuqi dhe depërtimit të kapitalit italian në Shqipëri. Tamam në këtë kohë Thanasi hyri në lëvizjen e organizuar komuniste të Shqipërisë dhe u bë anëtar i njërit prej grupeve të atëherëshme që vepronte edhe në qytetin e Beratit, i Grupit të Korçës.

Në Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë, atje ku bëhet fjalë për shtrirjen e organizatave komuniste, thuhet midis të tjerash: «Ngjarjet revolucionare të viteve 1935-1936 ishin një sukses i rëndësishëm i lëvizjes komuniste. Por ato kishin nxjerrë njëkohësisht në shesh një varg dobësish në organizimin e lëvizjes punëtore dhe antizogiste. Detyra e parë që dilte në këto rrethana ishte shtrirja e lëvizjes komuniste në të gjithë vendin, vendosja e lidhjeve më të shëndosha midis organizatave dhe bashkërendimi i veprimtarisë së tyre...»

Me këtë qëllim Grupi Komunist i Korçës krijoi në dhjetor 1936 një Komitet të ri drejtues, që u ngarkua të zhvillonte veprimtarinë në të gjitha qarqet e vendit. Ky komitet kishte si synim të kthehej në një qendër drejtuese të lëvizjes komuniste shqiptare. Por ai nuk ja arriti dot këtij synimi. Organizata të reja të Grupit të Korçës u krijuan vetëm në Berat dhe në Tiranë, ku u formua edhe shoqëria e punëtorëve tipografë...»

Pra, në qytetin e Beratit, ku erdhi për të punuar si sekretar gjyqi i shkallës I Thanas Zikoja, ekzistonte një degë e Grupit Komunist të Korçës. Kjo organizatë, sado e kufizuar që ishte, zhvillonte një propagandë komuniste dhe punonte për zgjerimin e radhëve me anëtarë të rinj. Sekretari i ri i gjyqit i qarkut të Beratit nuk mund të kufizohej me punën e zakonshme të zyrës. Ai në një mënyrë ose në tjetër do të zhvillonte një farë aktiviteti shoqëror dhe ky aktivitet, sado i kufizuar dhe spontan që të ishte në fillim, do të binte në sy të elementëve të organizuar në degën e Grupit të Korçës. Dhe kështu ndodhi.

Stavri Bojaxhi, pjesëmarrës i Grupit të Korçës dhe me punë në atë kohë në Berat, në kujtimet e veta shkruan: «Në shtator të vitit 1935 në kafenenë e Bashkisë së Beratit qe shtruar një banket, me sa më kujtohet mua, me rastin e festës së mbretit. Në këtë banket ishin ftuar elita e qytetit dhe shumica e nëpunësve të aparatit administrativ e gjyqësor. Në fillim u mbajtën fjalimet e rastit nga prefekti i qarkut të Beratit, nga kryetari i Bashkisë dhe nga një i dërguar i qeverisë qendrore, i cili kishte ardhur për të marrë pjesë në këtë festë. Pastaj u ngritën shumë doli, siç ndodh zakonisht në raste të tilla. Shumë nga pjesëmarrësit erdhën shpejt në qejf, sidomos pasi u larguan nga salla funksionarët e lartë. Befas, në mes të gjallërisë së madhe që mbretëronte në sallë, u ngrit në këmbë sekretari i gjyqit të qarkut të Beratit Thanas Zikoja dhe me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë, ngriti një doli për punëtorët, që, siç tha ai fjalë për fjalë, «nxjerrin me duart e tyre të

arta të gjitha të mirat». Njerëzit në fillim u hutuan. Një gjë e tillë s'kishte ndodhur kurrë në bankete zyrtare. Thanasi, duke vazhduar me vrull ligjëratinë e tij, filloi t'i hidhte shigjeta edhe regjimit zogist. Simpatizantët e lëvizjes komuniste dhe ata që e njihnin Thanasin u munduan ta qetësonin atë, që të mos bëhej ndonjë skandal më i madh. Afër mendjes se midis pjesëmarrësve që kishin mbetur në banket kishte edhe shërbëtorë besnikë të qeverisë, që u skandalizuan nga kjo që po ndodhte aty dhe nisën ta sulmonin Thanasin me fjalë. U bë një rrëmujë e madhe. Në çastin më kritik disa elementë përparimtarë u ngritën me qëllim dhe me fjalët e tyre e mbuluan gjer në një farë mase përshtypjen që kishte shkaktuar ligjërata e Thanas Zikos. Por s'ishte e mundur që kjo çështje të mbyllej fare e të mos shkonte në veshin e autoriteteve. Ditën tjetër Thanasin e thirrën në prefekturë. Bashkë me të thirrën edhe njerëz të tjerë, pjesëmarrës në banket. Thanasi do ta kishte shumë të vështirë në qoftë se nuk do ta kishin mbrojtur ata që ishin në një tavolinë me të, të cilët deklaruan se në banket me të vërtetë ishte shkaktuar konfuzion por Thanasi s'kishte thënë asgjë të keqe kundër regjimit në fuqi.

Kështu, Thanasi shpëtoi nga ndjekjet ligjore të menjëhershme, por ai u bë edhe më i dyshimtë për autoritetet e vendit, të cilët që prej asaj dite filluan të gjurmonin hap pas hapi çdo lëvizje të tij».

Ky veprim i Thanasit tregon se në shpirtin e tij ziente një urrejtje e thellë kundër regjimit anti-popullor të Zogut dhe kjo urrejtje shpërtheu me zhurmë, në një mënyrë krejt të papritur e spontane.

Nga ana tjetër, akti i tij tregon se ai ende nuk kishte gjetur rrugën e duhur për të luftuar në një mënyrë të organizuar kundër armikut të klasës, i cili kishte në dorë pushtetin dhe të gjitha mjetet e propagandës.

Pas kësaj ngjarjeje, komunistët e Grupit të Korçës, të cilët punonin në Berat, ju afruan Thanasit dhe i shpjeguan përse ishte e domosdoshme të hiqte dorë nga veprime të izoluara e spontane, që të çonin në anarkizëm dhe i propozuan të merrte pjesë në lëvizjen e organizuar komuniste të kohës. Thanasi pranoi menjëherë.

Aleks Çaçi, anëtar i degës së Beratit të Grupit të Korçës, lidhur me këtë gjë thotë: «Jo shumë kohë pas formimit të degës së Grupit të Korçës për Beratin u shtrua çështja e pranimit në organizatën tonë të sekretarit të gjyqit Thanasi Ziko dhe të disa elementëve të tjerë. Thanasi u pranua njëzëri si anëtar. Kështu, ai qëndroi në Grupin Komunist të Korçës gjer ditën që u detyrua të arratisesh nga Shqipëria për të mos rënë në duart e xhandarmërisë së Zogut, që e ndiqte këmba-këmbës...»

Sipas porosive dhe udhëzimeve që merrte nga celula, në të cilën bënte pjesë, Thanasi nisi të zhvilloste propagandë të gjithanshme për përhapjen e ideve komuniste në rrethet e punëtorëve, çirakëve e nëpunësve. Përveç punës agjitative e propagandistike me gojë, ai tregonte interes të veçantë edhe për shpërndarjen e gazetave komuniste e përparimtare që vinin nga jashtë nga revolucionarët shqiptarë të emigruar nëpër vendet e ndryshme të Ballkanit e të Evropës. Meqë këto gazeta vinin në shumë pak kopje, Thanasi rrinte gjer natën vonë për t'i kopjuar

e për t'i shumëzuar me maqinë ose me dorë dhe i shpërndante pastaj në shumë lexues.

Në një proklamatë të kopjuar me dorë nga Thanasi e që më vonë ra në duart e armikut thuhej: «Popull shqiptar! Mos u gënje më nga reformat dredharake të Zogut gjakësor dhe të pabesë, që ndërrojnë vetëm qimen për të siguruar më mirë sundimin e tij tiranik dhe tradhëtar!.. Popull! Mbaj sytë dhe veshët të çelur, se dita e lirisë është e afërme!...»

Një punë të mirë bënte Thanasi për të kopjuar e përhapur gazetën «Liria kombëtare», organ i përmuajshëm i Komitetit të çlirimit nacional dhe në mënyrë të veçantë artikujt e Halim Xhelos dhe të komunistëve të tjerë shqiptarë, që gjendeshin në emigracion.

Krahas punës për shpërndarjen e shtypit komunist e përparimtar ai nuk linte rast pa bërë agjitacion e propagandë kundër regjimit në fuqi si dhe për nevojën e bashkimit të popullit në një front të gjerë antizogist.

Filip Niko Spiri, nga fshati Këllëz i Lunxhërisë të rrethit të Gjirokastrës, kallëzon një episod të vogël, por shumë kuptimplotë për këtë anë të aktivitetit revolucionar të Thanasit: «Nuk më kujtohet mirë, por ishte muaji korrik a gusht i vitit 1935. Unë së bashku me tim vëlla udhëtonim me kamion nga Gjirokastra për në Tiranë. Midis pasagjerëve të tjerë që kishin hipur në kamion ishte edhe Thanasi Zikoja. Ne atëherë nuk njiheshim me Thanasin, madje gjer atë ditë as emrin nuk ja kishim dëgjuar. Por gjatë udhëtimit për në Tiranë, që zgjati afër dy ditë, u njohëm me të dhe patëm një bisedë që do të mbetet për ne e paharruar. Aty nga pasdrekja e

ditës së parë të udhëtimit mbërritëm në Vlorë. Shoferi na tha se s'mund të udhëtonim atë ditë, se maqina kishte pësuar një difekt e duhej ndrequr. Së bashku me Thanasin hymë në hotelin e parë që hasëm përpara dhe zumë një dhomë me tre shtretër. Gjithë pasditen dhe natën e kaluam bashkë. Ai na pyeti për punën e për hallet tona si, edhe për shkakun e vajtjes sonë në Tiranë. Im vëlla i tha se ne shkonim që të ankoheshim në qeveri për një padrejtësi që na ishte bërë nga autoritetet lokale. Thanasi buzëqeshi hidhur dhe na tha: «Sipas mendimit tim, s'keni për të gjetur drejtësi atje ku do të shkoni. Dhe kjo sepse qeveria e Tiranës bën padrejtësi të mëdha. Si është e mundur?! — do të thoni ju në këtë çast. Mirëpo nesër-pasnesër do ta kup-toni se kam të drejtë. Prandaj unë ju them me zemër të hapur: keni bërë shumë mirë që jeni nisur nga fshati për të trokitur në dyert e qeverisë, sepse kështu do të bindeni një herë e mirë për një gjë: se peshku është qelbur nga koka. Besoj se s'ka më nevojë për fjalë. Po të takohemi ndonjëherë tjetër do të flasim përsëri...»

Kaq tha Thanasi dhe heshti. Unë dhe im vëlla mbetëm për një çast si të hutuar. Thosha me vete: «Ç'flet kështu ky njeri? Sikur i ka parë me sytë e vet këto që thotë!» Im vëlla ishte pak më i hedhur se unë dhe e pyeti Thanasin: «Atëhere ç'duhet të bëjmë, sipas mendimit tënd? Ku të shkojmë ta qajmë hallin tonë?». «Dëgjo, vëlla, — ju përgjegj aty për aty Thanasi, — halli yt, halli im dhe halli i atij tjetrit të themi, nuk zgjidhen duke ju lutur njerëzve që kanë fuqinë në dorë. Oh, sa halle ka populli ynë! Ju e shikoni vetë se sa vuan ai. Shkaktarë të këtyre

vuajtjeve janë ata që na thithin gjakun si shushu-  
nja. Ata na pijnë gjakun, ndërsa ju shkoni dhe i  
luteni me të mirë! Jo, byrazer, kjo rrugë nuk ju  
nxjerr në dritë!..»

Thanasi qëndroi një çast dhe vazhdoi përsëri.  
Oh, me ç'zjarr fliste ai! Dukej sikur digjej nga  
brenda nga një urrejtje e papërmbajtur kundër  
njerëzve të qeverisë së Zogut, nga një dashuri e  
thellë për vegjëlinë, për popullin që vuante të  
zitë e ullirit. Kush i mban mend të gjitha fjalët që  
na tha Thanasi atë natë? Lëre pastaj që atë kohë  
ne shumë gjëra nuk i kuptonim ashtu siç i kup-  
tojmë sot... Pas disa ditësh e provuam edhe vetë  
se peshku ishte qelbur me të vërtetë nga koka. Tro-  
kitëm në shumë dyer të qeverisë për të qarë hallin,  
por të drejtën s'e gjetëm. Na përcillnin nga zyra në  
zyrë e nga ministria në ministri. Pasi u sorollatëm  
ndonjë javë kot së koti hoqëm dorë nga kërkesa  
jonë. Atëhere unë i thashë tim vëllai: «Sa të drejtë  
kishte Thanasi!». S'kaluan shumë vjet dhe ne i kuj-  
tuam fjalët e Thanasit. Ishte vera e vitit 1942. Në  
fshatin tonë erdhi një i dërguar nga partia, i cili  
na mblodhi në oborrin e shkollës dhe na foli gjerë  
e gjatë për ditët e zeza që kishte kaluar e po ka-  
lonte populli ynë nën thundrën e pushtesve të  
huaj dhe të tradhëtarëve. Foli edhe për nevojën e  
bashkimit të popullit dhe të organizimit të luftës së  
armatosur. Ndërsa ai fliste, im vëlla më shkundi një  
herë me bërrylin e dorës e më tha në vesh: «Ore,  
të kujtohet Thanasi Zikoja? Kështu na fliste edhe ai  
atëhere kur udhëtonim për në Tiranë...» Ndërkohë  
Thanasi kishte vdekur, por idetë komuniste që e  
frymëzonin atë po përhapeshin me shpejtësi në të

katër anët e Shqipërisë dhe po rrënjoseshin në shpirtin e njerëzve. Pak më vonë morëm vesh se andej nga fshatrat e Dropullit qe formuar batalioni partizan «Thanas Ziko». Atëhere u bindëm më mirë se fjalët e Thanasit e të komunistëve të tjerë, si një farë e shëndoshë që bie në tokë pjellore, kishin mbirë për bukuri e po jepnin frytet e para».

Vitin e fundit që qëndroi në Shqipëri, Thanasi zhvilloi një aktivitet revolucionar të gjithanshëm. Atë e gjeje kudo midis punëtorëve, zejtarëve, çirakëve dhe nëpunësve. Pasi mbaronte takimet dhe mbledhjet, ai kthehej në dhomë e fillonte të shumëzonte materialet ilegale, që ditën e nesërmen duhej të shpërndareshin midis simpatizantëve të lëvizjes komuniste dhe njerëzve të tjerë përparimtarë.

Duke u marrë çdo vit më shumë me punë revolucionare ai shkonte gjithnjë më rrallë në fshatin e lindjes. E ëma i shkruante gjithnjë letra dhe i kujtonte se, si njeri i martuar dhe kryefamiljar që ishte, kishte më shumë detyrime për të vajtur në fshat. «Tani edhe vajza është rritur, — i shkruante ajo në një letër. — Ajo të zë gjithnjë në gojë, tregon fotografinë tënde me gishtin e saj të vogël e belbëzon: Ja babi!»

Por Thanasi nuk gjeti kohë për të vajtur pranë familjes qoftë edhe për pak ditë. Kaliopi Ziko vendosi t'i shkonte vetë në Berat, ku punonte atë kohë i biri. Lidhur me takimin e fundit me të birin, ajo tregon: «Meqë Thanasi nuk erdhi në fshat për një vit e ca, mendova që të shkoja vetë në Berat për ta takuar. U nisa në prak të dimrit. «Ç'ka ai që nuk kthehet në shtëpi?» — thosha me vete gjatë rrugës dhe mendja më shkonte për të



keq. Por më doli krejt ndryshe. Nejse, ai më priti në agjencinë e maqinave dhe më çoi në hotel. Atë kohë Thanasi flinte në një dhomë të vogël, ku kishte vetëm një shtrat, një tryezë të vogël dhe dy karrige. Hotelxhiu na rregulloi edhe një shtrat të dytë atje në dhomën e vogël që të flija unë, sa kohë që do të qëndroja atje. Por ç'e do... Thanasin tim shumë pak e pashë gjatë ditëve që qëndrova në Berat. Ai gjithë ditën merrej me punë. Edhe kur kthehej në hotel nxirrte disa letra dhe shkruante e shkruante pa pushim. Ndodhte ndonjëherë që të mos kishte dritë në hotel. Atëhere ai ndizte dy qirinj, i vinte nga të dyja anët e tryezës e vazhdonte të shkruante.

«Mor djalë, — i thashë një natë, — ç'është kjo punë me ty? Kur do të çlodhesh? Do të sëmuresh e do të na marësh të gjithëve në qafë...» «Mos ki gajle, moj nënë, — m'u përgjegj ai, — mban kurrizi ynë, mban». «Edhe mban, edhe s'mban, Thanas. Ti rroptohesh gjithë ditën poshtë e lart, po të paktën çlodhu natën. Kështu nuk bën mirë». «Ç'të bësh moj nënë, ç'të bësh! Nuk shikon se ç'ndodh rreth nesh? Si mund të flesh i qetë, kur shikon se të tjerët vuajnë për bukën e gojës?»

Thashë me veten time: «Para 2-3 vjetësh, kur i kam vajtur njëherë në Tiranë, ai nuk ishte aq i zënë me punë. Ditën shkante në zyrë, por, kur mbaronte punën, kthehej në dhomë, fjalosej me mua, lexonte ndonjë gjë dhe pastaj flinte. Sa ka ndryshuar tani! Edhe sonte që është e diel s'gjen rehati. Ai e di që unë nesër do të largohem. Pra, ç'është kjo punë e ngutshme që nuk pret për nesër? «Nuk më thua, Thanas, — e pyeta, — ku shkon ti e ç'bën pasi mbaron punën e qeverisë?». Ai m'u përgjegj

si me të qeshur: «Ditën, moj nënë, punojmë për qeverinë, ndërsa natën luftojmë kundër saj». Mua më dogji kjo fjalë. M'u kujtuan fjalët që kryeplaku i fshatit i thoshte një ditë komshiut tim, me qëllim që ta dëgjonim unë dhe nusja e Thanasit: «Thanasi, or byrazer, ka dalë nga binarët dhe ka nisur avazin e bolshevikëve» — thërriste ai. Por ne nuk e kuptonim mirë se ç'donte të thoshte ai me këto fjalë dhe as që i besonim kryeplakut, që hante në një çanak me postkomandantin e fshatit tonë dhe bënte lloj-lloj dallaveresh e bataçillëqesh.

«Po shkojnë mirë punët tona, moj nënë. Tanët po fitojnë», — më tha Thanasi. «Për kë e ke fjalën, mor bir?» — e pyeta unë e habitur. «E kam fjalën për ata që përleshën fyt për fyt me të ligjtë dhe u japin atyre dërmën». E më foli e më foli për luftën e madhe që bëhej atëhere në një vend që, siç thoshte ai, «është mjaft larg që këtej, por ne e kemi në zemër». Asokohe unë s'e dija fare se ku luftohej, por më vonë shokët e Thanasit më shpjeguan se ai e kishte fjalën për Spanjën.

Nga që ishte në qejf nga lajmet e mira të luftës dhe nga që të nesërmen do të ndaheshim, Thanasi atë natë më hapi zemrën. Kurrë nuk do ta harroj bisedën e asaj nate! Mua më dukej sikur ishte ai, Thanasi i vogël, kur rrinim pranë zjarrit atje në kasollen e vogël, që kishim ngritur me duart tona pranë vreshtës sonë në Opsadhë dhe bisedonim për hallet e shtëpisë. Por tani ai nuk fliste më për kecin e bukur laraman, që i shkonte pas si manar, as për kumbullën e kuqe që e kishte mbjellë vetë aty mbi ledhin e vreshtës dhe që nga viti në vit rritej e zbukurohej. Ai fliste për luftën e të varfërve kundër

të pasurve, për shokët e tij të zemrës që luftonin me armën në dorë në një qytet të huaj, por të shtrenjtë për zemrat e njerëzve të mirë. Unë, ç'është e vërteta, shumë gjëra nga ato që më thoshte ai atë natë nuk i kuptoja mirë dhe më vinte aq çudi, sa herë-herë thosha me vete: «Thanasi im është ky që flet kështu?!»

Më në fund më tha: «Nënë, tani do të të them edhe diçka tjetër: mua më ndjekin ata të qeverisë...» «Djalë i nënës! — u hodha unë e tmerruar. — Ç'janë këto fjalë që nxjerr nga goja? Pse të të ndjekin ata të qeverisë? Ç'ke ti me njerëzit e qeverisë? Ata janë të fortë, ata janë të ligj e të bëjnë të keqen kur të duash. Si mund të matesh ti me ta?» «Nuk jam vetëm unë, moj nënë, jo! Ne jemi shumë. Oh, sa shumë jemi ne! Dhe përditë bëhemi më shumë e më të fortë. Ndjaj mos u shqetëso!»

Sado që ai u mundua të më qetësonte, unë tërë atë natë nuk mbylla sy. Herë-herë më vinte sikur xhandarët e ndiqnin Thanasin tim, e kapnin dhe e rrihnin me kondakët e pushkëve. Herë-herë më dukej sikur e futnin në një bodrum të thellë dhe e mbërthenin prej shpatullave në një mur plot lagështi...

Të nesërmen Thanasi më përcolli gjer në agjenci, po në atë vend ku më kishte pritur para pesëmbëdhjetë ditësh. Në një çast më shtrëngoi dorën e më tha: «Nënë! Në qoftë se mua do të më ndodhë diçka, ti duhet të mbahesh e fortë». «Më shtive frikën, Thanas, me këto fjalët e tua. Pse, ç'mund të të ndodhë ty, mor djalë? Më folë më hapur». «Moj nënë, mund të mos më ndodhë gjë. Po unë t'i them këto fjalë që të jesh e përgatitur për çdo gjë. Ja,

të themi se nesër mua më kapin xhandarët...». «Ty, Thanas, të të kapin xhandarët? Po pse të të kapin, mor bir, pse? Ç'të keqe ke bërë?» «Sot, moj nënë, nuk arrestohen ata që bëjnë gjëra të liga, por ata që luftojnë për të mirën e njerëzve». Djalë i nënës! Mos e ço punën gjer atje, se ti e di që unë përveç teje s'kam njeri tjetër në botë». «Jo, moj nënë, ke, ke shokët e mi», — arriti të më thoshte.

Maqina ishte bërë gati të nisej. E përqafova birin tim të shtrenjtë. «Nënë, mbahu gjithnjë e fortë». Këto ishin fjalët e tij të fundit, kjo ishte lamtumira më e mirë që më dha. Që atë ditë nuk e pashë më Thanasin tim. Vetëm emrin ja kam dëgjuar dhe e dëgjoj vazhdimisht nga qindra e mijëra njerëz...»

## BALLË PËR BALLË ME REGJIMIN E ZOGUT

Pas pranimit në radhët e Grupit Komunist të Korçës veprimtaria revolucionare e Thanasit jo vetëm që u zgjerua, por mori edhe një drejtim më të përcaktuar. Ai, si një anëtar aktiv i një organizate komuniste, luftonte për të krijuar lidhje të reja e më të ngushta me punëtorët, zejtarët, shegertët e intelektualët e dalë nga gjiri i popullit. Nga bloku i shënimeve që ju gjet gjatë bastisjes së dhomës nga xhandarët, del se Thanasi shkonte shpesh në Kuçovë për t'u takuar me shokët që punonin në këtë qendër të madhe punëtoresh të asaj kohe. Këto lëvizje të shpeshta e kjo veprimtari e vazhdueshme revolucionare nuk mund t'u shpëtonin organeve policore të regjimit në fuqi. Shokët e grupit, në të cilin ai bënte pjesë, e njoftuan Thanasin se autoritetet kishin vendosur ta arrestonin atë me të gjetur shkakun më të vogël.

Në këtë kohë gjendja e brendshme e vendit ishte shumë e trazuar. Lëvizja e Fierit vërtet kishte dështuar, por, siç shkruante militanti komunist Ali Kelmendi, ishte «pagëzimi i zjarrit dhe guri i provës» për komunistët shqiptarë. Këtë provë ata e

kaluan me nder dhe e treguan veten e tyre si vëllezër të denjë të komunistëve të vendeve të tjera». Prandaj Zogu, pas manevrës demagogjike të formimit të qeverisë me elementë gjoja liberalë, solli në fuqi një qeveri tjetër me politikanë që, siç theksonte Ali Kelmendi në atë kohë, «nuk janë vetëm elementët më reaksionar në Shqipëri, por edhe përkrahësit më të fortë të një orientimi pa kondita drejt Italisë».

Edhe në shkallë ndërkombëtare gjendja po acarohet e turbullohet gjithnjë e më shumë. Borgjezia e madhe, për të dalë nga kriza ekonomike që po trondiste nga themelet ngrehinën e vjetëruar të botës kapitaliste, sillte në fuqi në shumë vende të Evropës e të botës regjime fashiste. Pavarësisht nga format e jashtme, klikat fashiste, kudo që vinin në fuqi, nga njëra anë luftonin me terrorin më të egër kundër klasës punëtore dhe forcave përparimtare në përgjithësi, ndërsa nga ana tjetër pregatisnin në mënyrë të ethshme Luftën e parë botërore. Edhe në vendet e tjera të Evropës e të Amerikës, ku ruheshin ende format e jashtme të qeverisjes demokratike e të parlamentarizmit, lufta kundër komunistëve e njerëzve të tjerë përparimtarë bëhej gjithnjë më e stërholluar dhe më sistematike.

Në këtë gjendje të ndërlikuar e të acaruar si brenda ashtu edhe jashtë vendit, lufta e komunistëve shqiptarë bëhej gjithnjë më e vështirë. Ndjekjet dhe persekutimet nga ana e regjimit në fuqi ishin në rendin e ditës. Përditë arrestoheshin komunistë dhe njerëz të tjerë antifashistë, që luftonin kundër tiranisë së Zogut. Në ditët e para të vitit 1937 u muar vendimi për arrestimin e menjëhershëm të

Thanas Zikos. Shokët e lëvizjes në qytetin e Beratit e njoftuan Thanasin për këtë vendim të autoriteteve. Pasi u konsultua me ta, ai vendosi menjëherë të largohej për në Itali. Disa nga bashkëpunëtorët e tij të asaj kohe thonë se ai kishte nxjerrë që më parë një pashaportë për të dalë jashtë shtetit gjoja për arësye shëndetësore dhe këtë pashaportë e përdori në kohën e duhur. Disa të tjerë thonë se ai u largua nga Berati fshehtazi për në Vlorë dhe nga skela e këtij qyteti me një vapor mallrash kaloi Adriatikun dhe mbërriti në Itali. Në këtë mënyrë u shpëtoi nga dora xhandarëve të Zogut në çastin e fundit.

Gazeta «Zëri i popullit» në numrin e saj të tetorit të vitit 1942 shkruante për këtë akt të heroit tonë: «Thanasi mori pjesë në «Lëvizjen e Fierit», hyri në luftë të hapur me njerëzit e regjimit dhe më në fund u detyrua të merrte rrugën e mërgimit që të shpëtonte nga burgjet e errëta të xhelatëve».

Në Itali Thanasi zbriti në qytetin e Barit. Që andej dërgoi kartolinat e letrat e para në Shqipëri. Në një kartolinë që i dërgonte nga Italia Stavri Bojaxhiut në Berat i shkruante: «Së shpejti shkoj në tokën e amëshuar». Është më se e qartë se në këtë rast bëhej aluzion për Spanjën e për Luftën e Spanjës, që në atë kohë ishte bërë një nga frontet kryesorë të përleshjeve të mëdha klasore të popujve përparimtarë kundër fashizmit ndërkombëtar. Nga sa tregojnë shokët e tij më të ngushtë të asaj kohe, Thanasi kishte shfaqur dëshirën për të shkuar vullnetar në Luftën e Spanjës që në vjeshtën e vitit 1936, kur vullnetarët e parë të brigadave internacionale qenë përleshur me forcat fashiste në dyert

e Madridit. Edhe pashaportën që mund ta ketë nxjerrë për të dalë jashtë shtetit, gjoja për t'u kuruar, do ta kishte marrë me siguri për të vajtur vullnetar në Spanjë. Por midis dëshirës së njerëzve dhe realitetit objektiv ka gjithnjë pengesa dhe faktorë të parashikuar. . .

Ndërkohë në Berat u arrestuan të gjithë shokët që morën kartolina ose letra nga Thanasi. Aleks Çaçi dhe Stavri Bojaxhi, që ishin midis të arrestuarve, tregojnë për këtë ngjarje: «Në fillim ne nuk e kishim plotësisht të qartë përse autoritetet kishin marrë masa kundër nesh. Kur na liruan, morëm vesh se Thanasi i kishte dërguar një letër nga Italia edhe prefektit të Beratit, me anën e së cilës e demaskonte ashpër këtë përfaqësues besnik të regjimit të Zogut. Nga këto masa të rrepta të autoriteteve të Beratit gjithë qyteti e mori vesh se Thanasi Zikoja ishte nisur si vullnetar për në Spanjë, gjë që i kishte zemëruar pa masë njerëzit e regjimit».

Më 12 shkurt të vitit 1937 nga Bari Thanasi i shkroi një letër kryetarit të gjyqit të klasit të parë në Berat, i cili kishte qenë njëkohësisht edhe përgjegjësi i tij gjatë dy vjetëve të fundit. Në këtë letër, që ruhet edhe sot në Arkivin e shtetit, Thanasi i shpjegonte arësyet që e kishin detyruar të largohej nga detyra. Midis të tjerave ai shkruan: «Kur të mbërrij në vendin për ku jam nisur...» Nga kjo frazë bëhet e qartë se Thanasi nuk ishte arratisur vetëm për të shpëtuar nga arrestimi. Ai ishte nisur për në një vend të caktuar, me një qëllim që ja kishte vënë vetes prej kohe. Dhe ky vend s'mund të ishte tjetër, përveç Spanjës.



Letra e Thanasit dërguar kryetarit të gjyqit të Beratit është interesante, se na tregon shumë gjëra për gjendjen, mendimet dhe qëllimet e tij në atë kohë: «Unë nuk kthehem më nën regjimin barbar të Zogut e të memurëve të tij...» — shkruante më poshtë. Thanasi, me gjithë kushtet e vështira në të cilat gjendej, perspektivën e kishte shumë të qartë. Po në këtë letër ai shkruante: «Por duhet të jesh i sigurt se do të kthehem një ditë...»

Pasi shkruante dhe për disa çështje të tjera, që kishin të bënin me dorëzimin e zyrës së gjyqit, letra përfundonte: «Ministrin të korruptuar Orologajt<sup>1)</sup> i kam shkruar dhe ta mbaj mend letrën time, ashtu edhe Musa efendisë<sup>2)</sup>, të cilit kam për t'ja fshirë emrin e tij me... (Më falni për përdorimin e fjalëve, se nuk e dini në ç'gjendje ndodhem)...».

Po ndërkohë ç'ndodhte në Shqipëri? Autoritetet e Zogut e kishin të qartë se ish-sekretari i gjyqit të Beratit ishte arratisur jo për t'u fshehur në ndonjë vend të vetmuar për të gjetur rehati, por për të vazhduar luftën.

Siç ishte e natyrshme dhe siç mund të pritej, maqina rangallë e regjimit në fuqi u vu menjëherë në lëvizje kundër Thanas Zikos. Gjykata e posaçme për faje politike e Tiranës shpallte: «Mbasi nuk asht zanun Thanas Ziko, banues në Berat, që

---

1) E ka fjalën për ministrin e drejtësisë së asaj kohe Th. Orologaj.

2) Bëhet fjalë për ministrin e Punëve të Brendshme Musa Jukën.

pandehet për propagandë kundër regjimit, Kryetaria e gjykatës së posaçme për faje politike, që prej datës së shpalljes së këtij vendimi të pandehunit të përmendun i jep dhetë ditë afat me ju prezantue gjykatës. Në qoftë se nuk i paraqitet gjykatës brenda këtij afati, vërtetohet se nuk don me ju bind ligjës dhe kështu ka me u shikue gjyqi në mungesë, kanë me ju rrëzue të drejtat civile, ka me ju sekuestroue pasunia dhe në asnji mënyrë nuk ka ma të drejtë ankimi mbi veprimet e bamuna...»<sup>1)</sup>.

Pas këtyre kanosjeve të mbuluara me frazeologji ligjore, Gjykata e posaçme, besnike e frymës që sundonte në atë kohë në të gjitha hallkat e aparatit shtetëror, lëshoi urdhërin kategorik: «Të gjithë gjendarmët e policët janë të detyruem për zanjen e tij»<sup>2)</sup>.

Ndjekjet formale që pasuan dëshmojnë për tërbimin e xhelatëve kundër një të riu që ndjek me vendosmëri rrugën revolucionare. Ja një akt tjetër formal mbajtur në Berat, që tregon hidhërimin e atyre që nuk arritën të shtonin në aktivitetin e tyre edhe një «heroizëm» tjetër kundër armiqve të regjimit në fuqi:

«Procesverbal,

i mbajtur mbi arratisjen e Thanas Zikos, ish-sekretar i gjyqit të këtushëm.

Sot... ditën e martë ora 12 në zyrën e postkomandës qytetëse, i nënshkruari kapter Myrto Qafa me cilësi komandant i Postës qytetëse, duke pa-

---

1) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

2) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

tur pranë tetar Nexhip Shabanin dhe sekretarin e postës së gjindarmërisë Myrteza Xheladinin verbalizojmë për sa vijon:

Për t'i dorëzuar letërndalimin e përhershëm të Gjykatës politike të pandehurit për faje politike Thanas Zikos, i cili më datën 2 frur të këtij viti ka dalë jashtë shtetit dhe nuk u kthye më, duke marrë formën e arratisjes, duke qenë kështu letër ndalimi i përhershëm mbetet i pakomunikuar, e cila bashkë me këtë procesverbal i paraqitet prokurorisë së shtetit të Beratit për formalitete përkatëse. . . »<sup>1)</sup>

Siç del nga ky procesverbal, letra e ndalimit të Thanas Zikos u mbeti në dorë xhandarëve të Zogut. Mirëpo ndjekjet kundër të arratisurit Thanas Ziko nga autoritetet e Zogut vazhduan. Ja një dokument karakteristik i asaj kohe i dalë nga Ministria e Brendshme dhe e nënshkruar nga vetë ministri famëkeq i këtij dikasteri në vitin 1937 Musa Juka:

«Mbretëria shqiptare

Ministria e Punëve të Brendshme

Zyra sekrete

N = 221/3 Rez.

Tiranë 24.II. 1937

Prokurorisë së gjyqit politik

*Tiranë*

Për të bamë ndjekje ligjore, bashkangjitur kemi nderin t'ju referojmë:

1) Nji letër që z. Thanas Ziko, sekretar i gjy-

---

1) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

katës së shkallës I të Beratit, i ka dërgue nga Bari kryetarit të gjykatës së shkallës I të Beratit.

2) Dy kopje proklamatah: Popullit shqiptar e Kuvendit të Komitetit të lidhjes nacionale liberale.

3) Nji shkresë me titull «Qëllimi i shoqnisë jashtëshkollore» me pesë faqe dhe një shkresë tjetër e shkrueme prej tij.

4) Nji gazetë me emën «Buletini i lirisë kombëtare», dt. 15 janar 1936, që ju gjendën në arkivën e zyrës së tij.

Ministri

(Musa Juka)<sup>1)</sup>

Pas kësaj shkrese gjithë instancat e tjera të aparatit shtypës zogist vepruan me një shpejtësi jo të zakonshme për atë kohë.

Hetuesia e posaçme nxori një vendim të veçantë, në të cilin thuhet:

«Akt-hetim,

I mbajtur mbi kërkimin e Prokurorisë së posaçme për faje politike më dt. 1.III.1937 kundër të pandehunit Thanas Zikos, ish-sekretar i gjyqit shkallës I në Berat, i akuzuem për sjellje nga jashtë gazetash të ndalueme, të cilat, për t'i përhapun, i ka kopjue në maqinë. Me t'u dorëzue të gjitha aktet rreth çështjes kërktoj ndjekje ligjore kundër tij.

Tiranë 9.III.1937

Hetuesi i posaçëm. <sup>2)</sup>

---

1) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

2) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

Pas ndonjë muaji, më 15.IV.1937 Prokuroria e posaçme për faje politike i drejton këtë shkresë gjyqit të posaçëm për faje politike:

«Siç rezulton nga dosja hetimore Nr. 3, mbajtur prej hetuesit të posaçëm për faje politike, i quajtur Thanas Ziko, ish-sekretar i gjykatës së shkallës I të Beratit, pandehet se me qëllim propagande kundër regjimit ka sjellë nga jashtë fletore propaganduese, të cilat, mbasi i kopjonte, i shpërndante artikujt e tyre. Prandaj kundër tij kërkohet të bahen ndjekje ligjore duke u thirrë para gjyqit për t'u gjykue në bazë të nenit 9 në kombinim me nenet 1 e 2 të ligjit ndëshkimor për faje politike»<sup>1)</sup>.

Në këtë mënyrë të gjitha formalitetet ishin plotësuar, madje ishin përcaktuar edhe nenet e kodit penal të asaj kohe, në bazë të të cilave do të jepej dënimi. Por në këtë çështje mungonte protagonistin, mungonte i akuzuari. Megjithatë, më 23.X.1937 në një sallë të mbyllur të gjykatores së Tiranës filloi gjyqi politik kundër Thanas Zikos, sigurisht në mungesë.

Gjykatësit zunë vend dhe pas tyre prokurori. Në sallë atmosfera ishte e rëndë. Të gjithë heshtnin. E mori fjalën kryetari i gjyqit Alidin Xhiku. Zëri i tij tingëllonte në mënyrë të çuditshme në këtë sallë bosh. Ai tha: «Mbasi i pandehuni Thanas Ziko u thirr dhe nuk erdhi, kërkohet vazhdimin e gjykimit në mungesë».

Pas kryetarit të gjyqit, prokurori filloi akuzën me këto fjalë:

«I pandehuni në arrati Thanas Ziko, ish-sekre-

---

1) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

tar gjyqi në Berat, asht sjellë si i pandehun para gjykatës zotnisë suej si propagandist kundër regjimit, duke sjellë nga jashtë fletore e materiale të tjera, që përhapin propagandën kundër shtetit e regjimit, që i kopjonte dhe i shpërndante. Vepra e tij si ma sipër provohet me aktet e paraqituna...

Ai ka shkelun nenet 1 e 2 të kodit ndëshkimor për faje politike në kombinim me nenin 9 po të atij ligji. Prandaj, në bazë të dispozitave, kërkohet caktimin e dënimit të tij...»

Prokurori, duke lexuar pretencën, hidhte shpeshherë syrin nga banka e të akuzuarit. Por ajo ishte bosh. I akuzuari ndodhej shumë larg dhe nuk dëgjonte se ç'bëhej këtu. Ai ishte duke vazhduar luftën kundër këtij regjimi obskurantist, që kërkonte t'i merrte shpirtin popullit. Po të ndodhej këtu, në këtë sallë të mbyllur e të zymtë, ai do të dinte të mbronte pikëpamjet e tij. A nuk kanë vepruar gjithnjë kështu komunistët e vërtetë edhe kur ishin me pranga në duar? Dy vjet më vonë komunistët shqiptarë në gjyqin e Tiranës, midis të cilëve kishte edhe shokë të ngushtë të Thanasit, ju dhanë një përgjegje të merituar prokurorëve dhe gjykatësve të atij regjimi të degjeneruar, që përballë ideve shpëtimtare të komunizmit, s'kishin asnjë armë tjetër, përveç gënjeshtreve, plumbave dhe kërbaçit.

Kryetari i gjyqit shfletonte me nxitim dosjen e të akuzuarit, sikur kërkonte të zbulonte diçka që i kallte frikën. Nga mesi i shkresave i doli përpara një letër e shkruar me ngutje nga dora e atij që gjykohej. Letra në të vërtetë i drejtohej një kryetari tjetër gjyqi. Po atij i dukej sikur i drejtohej edhe atij edhe të gjithë kryetarëve dhe xhelatëve të tjerë

të regjimit. Dhe kryetarit sikur ju zu fryma kur lexoi frazën: «Të jesh i sigurt, se do të kthehem një ditë!» Mori menjëherë lapsin dhe u mat t'i prishte ato fjalë. Po ç'të mirë do të kishte edhe sikur t'i fshinte fare? Ç'përfitim do të kishte dhe sikur t'i jepte të akuzuarit dënimin më të rëndë që parashikonte ligja ndëshkimore në fuqi? Idetë që përfaqësonte i pandehuri që gjykohej në mungesë as që mund të dënoheshin, as që mund të mbylleshin në sirtar të bashku me dosjet e gjyqit dhe as që mund të frenoheshin. Ndoshta më shumë se të tjerët, ai, kryetari i gjyqit, e ndjente pafuqinë e regjimit ndaj ideve që përfaqësonte i pandehuri në mungesë, prandaj shpejtoi t'i jepte fund kësaj pune. U ngrit në këmbë dhe tha me një frymë: «Meqenëse nuk mbeti gjë tjetër, duhet me marrë vendim».

Edhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues u ngritën si të lehtësuar dhe u tërhoqën me të shpejtë nga salla. Pas disa minutash ata u kthyen për të zënë vendet e tyre. Salla ishte bosh. Populli nuk ishte i pranishëm. Te dera e sallës dallohej vetëm një xhandar me armën në dorë. Kur u ngrit kryetari, xhandari zgjati kokën për të dëgjuar mirë vendimin. Zëri i kryetarit ishte çuditërisht i ndryshuar, kur filloi të lexonte me nxitim një copë letër:

«Vendim,

Prokurori për faje politike ka dërguar para kësaj gjykate për t'u gjykue Thanas Zikon nga katundi Sopik i Libohovës dhe ish-sekretar i gjyqit të shkallës I Berat, sepse:

Ka futun fletushka dhe gazeta në Shqipni fshehtas, të gjitha me tendenca politike kundër regjimit, fakte këto që u provuen me elementët e poshtëshënuem:

— Me një artikull që përmban qëllimet e shoqnisë jashtëshkollore dhe në të cilin i pandehuni shoqnues në fjalë kërkon t'i japë për direktiva politikën dhe këtë të drejtuem kundër regjimit dhe personave që e përfaqësojnë.

— Me faktin e kapjes së Buletinit të Lirisë kombëtare në tryezën e punimit të të pandehunit në gjykatën e shkallës I të Beratit.

— Me letrën dt. 12.III.1937 që i ka dërgue kryetarit të gjykatës së shkallës I të Beratit, z. Avni Kokës dhe në të cilën shfaq mërinë dhe urrejtjen që ushqen për këtë regjim.

Meqenëse fajësia e të pandehunit Thanas Ziko parashikohet prej nenit 9 të kodit ndëshkimor për faje politike në kombinim me nenin 1 e 2 po të atij ligji,

Prandaj,

Gjykata, në mbështetje të neneve të nalttregueme dhe konform me vendimin e prokurorit të posaçëm bashkarisht,

## V e n d o s i

Dënimin e Thanas Zikos, ish-sekretar i gjyqit të shkallës I Berat, e tash i arratisun, me 10 vjet burgim dhe në bazë të nenit 13 të po atij ligji



konfiskimin e pasunisë së tundshme e të patundshme»<sup>1)</sup>

Interesant është një fakt i vogël, por shumë karakteristik, që del nga procesverbali i mbajtur gjatë seancës së këtij gjyqi. Në paragrafin e fundit duket e shkruar qartë: «Dënimin e Thanas Zikos... me 15 vjet burgim». Pastaj këto tri fjalët e fundit janë prishur me laps dhe më poshtë është shkruar: «... me 10 vjet burgim».

Kuptohet se varianti i parë ishte për 15 vjet burgim. Nga procesverbali del se për afatin e dënimt nuk ishin të gjithë anëtarët e gjyqit të një mendimi. Dhe vendimi u muar për 10 vjet. Por kjo s'kishte asnjë rëndësi. Ky dënim do të mbetej gjithnjë në letër dhe nuk do të vihej kurrë në jetë. Pas shtatë-tetë vjetësh xhelatët e luftëtarëve të lirisë dhe tradhëtarët e çdo kallëpi do të jepnin llogari për krimet e tyre përpara gjyqit të popullit. Në këto gjyqe shërbente një skuadër partizanësh, që gjatë kohës së luftës ishin efektivë të batalionit partizan «Thanas Ziko». Parashikimi i Thanasit doli i vërtetë! Ajo ditë, për të cilën bënte aluzion ai në letërn e tij drejtuar kryetarit të gjyqit të Beratit, erdhi.

---

1) Arkivi i shtetit, dosja e Thanas Zikos.

## BURGJE DHE SANATORIUME

Kishin kaluar vetëm tetë vjet që nga ajo ditë që djaloshi Thanasi Ziko që nisur nga fshati i tij i lindjes për të kërkuar një punë e për të çarë një shteg në jetën e mbyllur e të zymtë të asaj kohe. Djali i ve-gjëlisë, që ishte rritur jetim, i ndjente thellë vuajtjet e popullit që ishin edhe vuajtjet e tij. Ndaj kishte ni-sur prej kohësh të kërkonte shkakun, burimin e së keqes. Gjatë kërkimit kishte ardhur në kontakt me komunistët e parë shqiptarë dhe kështu kishte fi-lluar të njihej me idetë komuniste që pak nga pak i përqafoi plotësisht. Në fillim revoltën e tij të brend-shme ndaj padrejtësive shoqërore ai e shfaqte në më-nyrë spontane dhe të paorganizuar. Por në shkollën e madhe të jetës dhe me ndihmën e komunistëve të Grupit të Korçës Thanasi kaloi gradualisht në luf-tën revolucionare të ndërgjegjshme e të organizuar. Kur i dolën përpara njerëzit e regjimit tiranik, ai me një veprim të shkathët e të guximshëm u shpë-toi nga dora dhe shkoi jashtë atdheut për të vazhduar luftën në një front më të gjerë. Në rrethanat që u krijuan për të jashtë vendit të tij, Thanasi u bë shu-

më shpejt një revolucionar i vërtetë, që të gjitha forcat dhe aftësitë e tij ja kushtoi çështjes së madhe të komunizmit. Ai e dinte se rruga që i hapej përpara ishte e vështirë, por shpirti i tij ziente nga një patos revolucionar dhe një vendosmëri e pathyeshme. Gazeta «Zëri i popullit» në numrin e saj të tetorit të vitit 1942, shkruante për këtë anë të karakterit të tij:

«Thanasi qe revolucionar me temperament, jeta pa luftë dhe në rehati nuk i pëlqente fare. E ndjente që kishte një mision në jetë, kishte misionin e luftëtarit të lirisë».

Në Bari Thanasi qëndroi vetëm pak ditë, sepse autoritetet fashiste italiane mund ta arrestonin e ta dorëzonin në xhandarmërinë e Zogut, që ndiqte çdo lëvizje të tij jashtë shtetit. Përveç kësaj, ai qe nisur për në vendin ku luftohej me armë në dorë kundër fashizmit, për në Spanjë. Për të shkuar në Spanjë ishte më lehtë nga Italia. Por në Itali sundonte prej vitesh fashizmi. Edhe në vendet e tjera të Evropës vala fashiste në atë kohë ishte në ngritje. Ishte koha kur nga portet e Italisë niseshin divizione të tëra fashiste për të luftuar kundër popullit spanjoll e për të gjetur disfatën e turpshme dhe vdekjen e palavdishme në fushat e betejës së Guadalaharës e të Guadraremës. Por ndërsa qeveritë reaksionare të Italisë fashiste e të Gjermanisë hitleriane dërgonin në ndihmë të fashistëve të Frankos divizione të korracuara dhe skuadrilje të shumta aeroplanësh të teknikës së fundit të asaj kohe, fuqitë e mëdha hipokrite të Evropës Perëndimore, që sundonin në Lidhjen e Kombeve, me pretekstin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të Spanjës, bënë çmos që të

ndalonin me çdo mënyrë vajtjen e vullnetarëve në ndihmë të popullit spanjoll.

Kështu, meqë rruga më e shkurtër për të shkuar në Spanjë ishte e mbyllur, Thanasi u detyrua të ndërronte drejtimin e të shkonte përsëri drejt lindjes, për në Ballkan. Me vaporin e parë që gjeti, u nis nga Bari për në Greqi. Mirëpo s'kishte as pashaportë, as vizë të rregullt nga konsullata greke e Italisë. Prandaj u muar si njeri i dyshimtë dhe u mbajt disa ditë nën vërejtje në Korfuz.

Nga Korfuzi Thanasi i shkroi një letër të shkurtër familjes në fshat, ku thuhet: «Shpëtova për qime nga dora e xhandarëve në Berat dhe arrita në Itali. Që andej kam ardhur këtu në Korfuz, ku nuk do të rri shumë. Meqë jam në rrugë dhe më dalin pengesa të papritura nga të gjitha anët, mos prisni nga unë letra rregullisht. Kur të mbërrij në vendin për ku jam nisur do t'ju shkruaj menjëherë».

Pas shumë pengesash arriti të marrë leje nga autoritetet greke të ishullit për të vazhduar rrugën më tutje, drejt Pireut.

Edhe në Athinë, ku e gjejmë Thanasin pas disa ditësh, asfalia greke e ndoqi dhe e mbajti për një kohë nën vërejtje. Në këtë pikë s'ka asgjë për t'u çuditur, po të marrim parasysh se edhe në Greqi që prej vitit 1936 kishte ardhur në fuqi qeveria reaksionare e Metaksait, e cila nuk kishte asnjë ndryshim nga qeveritë e tjera fashiste të Evropës së paraluftës.

Po të qëndronte shumë kohë në Greqi, autoritetet fashiste të Metaksait do të merrnin vesh për aktivitetin revolucionar e për arratisjen e Thanasit nga

Shqipëria. Në një rast të tillë ata do të kërkonin ta hiqnin qafe një element komunist ose duke ua dorëzuar autoriteteve shqiptare, ose duke e internuar në ndonjë ishull të shkretë të Egjeut, ashtu siç vepronin edhe me komunistët vendës. Prandaj Thanasi, me ndihmën e disa bashkëfshatarëve që ndodheshin në Athinë, u mundua të largohej sa më parë nga Greqia. Bashkëfshatari dhe shoku i tij i ngushtë Kristo Çevi tregon për qëndrimin e Thanasit në kryeqytetin grek:

«Gjatë vitit 1937 kam qenë student në Fakultetin e drejtësisë të Universitetit të Athinës. Një bashkëfshatar më tha se ishte takuar me Thanas Zikon, i cili kishte ardhur atje si emigrant politik. Unë në fillim nuk u besova këtyre fjalëve, sepse e dija që Thanasi punonte si sekretar gjyqi në Berat. Para disa muajve dhe pikërisht në verë të vitit 1936 së bashku me dy bashkëfshatarë të tjerë ne kishim vajtur në Berat për një problem të fshatit. Thanasi atëhere na kishte pritur me përzemërsi, ishte treguar i gatshëm për të na ndihmuar me ç'kishte në dorë dhe na kishte shoqëruar gjer në Tiranë. Pas disa ditësh, kur e pashë Thanasin te dera e dhomës sime, u habita shumë. «Ti Thanas këtu?» — i thashë në çastin e parë. «Ç'ka këtu për t'u habitur? — m'u përgjegj ai duke buzëqeshur. Dhe më kallëzoi me imtësi peripeçitë e tij të fundit, të cilat ende nuk kishin marrë fund. Për planet dhe qëllimet e tij në të ardhmen nuk më tha gjë. Ai dinte t'i mbante me rreptësi rregullat e konspiracionit revolucionar. Gjatë qëndrimit në Athinë policia greke nuk e linte Thanasin të qetë. Përveç kësaj, ai nuk ishte mirë edhe me shëndet. Ne bashkëfshatarët u interesuam dhe e çuam në një kli-

nikë private. Mjeku që e vizitoi i tha se kishte marrë të ftohtë, duhej të rrinte në shtrat disa ditë me radhë dhe të merrte ilaçet që do t'i jepte ai. Kur u ndamë me mjekun, Thanasi buzëqeshi hidhur dhe tha: «Ai mendon se unë i kam të gjitha gjërat në vijë dhe kam nge të rri i mbyllur në shtëpi. Ai s'e di se njerëzit si unë s'kanë as shtrat as shtëpi dhe atje ku i gjen mëngjezi nuk i gjen mbrëmja». Pas dy-tri ditësh Thanasi u largua me tren për në Jugosllavi pa marrë fare ilaçet që i kishte dhënë mjeku. Ky ishte takimi im i fundit me Thanasin.»

Në Jugosllavi Thanasi gjeti pengesa edhe më të mëdha për të vazhduar rrugën për në Spanjë. Qeveria profashiste jugosllave e asaj kohe kishte vendosur një karantinë të rreptë nëpër skelat e pikat e daljes së kufirit, për të mos lejuar asnjë njeri të shkonte si vullnetar në Luftën e Spanjës. Thanasi, që nuk kishte pashaportë dhe njerëz të njohur, në këtë ambient të huaj dhe armiqësor e kishte shumë të vështirë të kalonte kufirin jugosllav për të shkuar në «tokën e amëshuar».

Në një gjendje të tillë, kur nuk shihte asnjë rrugëdalje tjetër, Thanasi vendosi të kalonte kufirin jugosllav-rumun. Ndoshta ka patur qëllim të arrinte në Bashkimin Sovjetik dhe që andej të shkonte në Spanjë. Por në çastin e kalimit të kufirit ai ra në duart e xhandarmërisë rumune. Më vonë ai u kishte kallëzuar shokëve të tij të ngushtë në Francë se autoritetet policore rumune e kishin marrë në fillim për një të dërguar të Kominternit, për të cilin kishin të dhëna se ato ditë do të hynte në tokën e Rumanisë. Prandaj e kishin trajtuar shumë keq. Që prej ditës së arrestimit, për Thanasin filloi periudha më e

vështirë e jetës së tij, periudha e vuajtjeve të mëdha. Xhandarët rumunë, sipas urdhërit që patën nga qendra, e përcollën të lidhur nga një burg në tjetrin, gjersa e sollën në burgun mesjetar të Doftanës. Ky burg famëkeq që caktuar nga qeveria rumune për komunistët më të rrezikshëm për regjimin fashist e prohitlerian të Rumanisë së paraluftës. Në burgun e Doftanës Thanasin e torturuan në mënyrë barbare e çnjerëzore, duke shpresuar se do të nxirrnin prej tij të dhëna të vlefshme për veprimtarinë ilegale të Partisë Komuniste të Rumanisë. Pasi nuk morën gjë, e mbyllën për disa muaj në një birrucë të errët e me lagështi, duke shpresuar se, duke e izoluar plotësisht, do ta thyenin vullnetin e tij të papërkulur. Po përsëri qëllimi i tyre nuk u realizua. Më vonë, kur shokët e pyesnin si me shaka se cili ishte burgu më i keq që kishte «vizituar», Thanasi u përgjigjej: «Burgu më i keq që kam parë gjer më sot në jetën time, është ai i Rumanisë».

Në burgun fashist të Doftanës Thanasi u sëmur që ditët e para nga pleviti. Ushqimi i keq, torturat, lagështia dhe vetmia e plotë bënë që kjo sëmundje të kthehej shpejt në tuberkuloz. Pas 6-7 muajve Thanasi u lirua nga ky burg fashist duke qenë i detyruar të kthehej përsëri në Jugosllavi.

Pasi u kthye në Beograd, Thanasi erdhi menjëherë në kontakt me emigrantët politikë shqiptarë. Shumë shpejt ai u njoh edhe me studentët shqiptarë që vazhdonin studimet në universitetin e atjeshëm, me të cilët punoi pa ndërprerje gjatë gjithë qëndrimit të tij prej disa muajsh në kryeqytetin e Jugosllavisë. Duart nuk i kishte më të lidhura me pranga, por mushkëritë e tij ishin të copëtuara. Tu-

berkulozi do ta shoqërojë atë gjatë gjithë jetës.

Për aktivitetin e Thanasit në Beograd, pas lirit nga burgjet e Rumanisë, Prenk Uli, emigrant dhe ai në atë kohë në kryeqytetin jugosllav, tregon: «Në fillim të vitit 1937 u përhap lajmi në të gjitha rrethet antizogiste në Shqipëri se sekretari i gjyqit të Beratit Thanas Ziko ishte arratisur për të vajtur vullnetar në Spanjë. Atëhere e dëgjova për herë të parë emrin e komunistit Thanas Ziko. Pa kaluar dy-tre muaj unë u detyrova të arratisesha nga Shqipëria, për të shpëtuar nga ndjekjet e persekutimet e Musa Jukës e të xhelatëve të tjerë. Gjatë qëndrimit tim në Beograd m'u dha rasti të njihesha edhe me Thanas Zikon. Ishte një ditë dimri me borë e me erë të fortë. Në kafenenë «Albania» të Beogradit, ku mblihdeshin zakonisht emigrantët dhe studentët shqiptarë, hyri një njeri i gjatë, i ri në moshë, por koskë e lëkurë e me një bastun në dorë. Në tavolinën ku rrinim ne ishte edhe një i njohuri i tij, prandaj ai erdhi dhe u ul atje. Pasi u prezantuam me njëri-tjetrin, unë gjeta rastin dhe e pyeta si mënjane: «Po ju sikur jeni nisur për në Spanjë...» Ai më hodhi një vështrim hetues e nuk më tha gjë. Pasi mori vesh që edhe unë isha i arratisur politik, të nesërmen e hapi vetë bisedën, duke më pyetur mua: «Nga e dije ti që unë do të shkoja në Spanjë?» «Këtë gjë e kisha dëgjuar nga shokët tanë qëkur ndodhesha ende në Shqipëri», — ju përgjegja unë. «Po, për atje jam nisur, — më tha, — por, siç e shikon edhe vetë, ndodhem ende në mes të rrugës. Dhe jo sepse Spanja është larg, por sepse rreth atij vendi revolucionar duan të krijojnë një kordon izolimi, që ta mbysin Republikën e re spanjolle. Unë



u mundova ta çaja këtë rrethim, por më kapën disa herë e më hodhën nëpër burgje. Gjer tani kam parë disa burgje, po burgu fashist i Rumanisë më hëngri jetën. Atje armiku i klasës «më fali» tuberkulozin. Reaksioni ballkanik është shumë i egër. Këtë egërsi unë e provova në veten time. Edhe në vendet e tjera të Evropës fashizmi po kalon në sulm. Ndaj na presin përleshje të mëdha e të ashpra. Ajo e Spanjës mund të jetë prova gjenerale, si i thonë, para shfaqjes së vërtetë...»

Gjatë qëndrimit të tij në Beograd ne takohehim shpesh. Një ditë Thanasi m'u afrua e më tha si mënjane: «Më në fund m'u dha pashaporta për në Francë. M'u desh të bëhesha tuberkuloz që të siguroja daljen nga Jugosllavia për në Paris. Si duket, nuk kanë më frikë nga një njeri i sëmurë. Por janë të gënjer. . . Sidoqoftë, kur të mbërrij në Francë e të marr kontakt me shokët e atjeshëm do t'ju shkruaj menjëherë si të veprojnë edhe shokët e tjerë që kanë ndër mend të shkojnë në Spanjë».

Pas disa ditësh e përcollëm Thanasin në stacionin e trenit. Bashkë me ne, emigrantët, kishte edhe studentë shqiptarë e kosovarë. Ai miqësohej shumë shpejt me njerëzit dhe i bënte ata për vete. Në çastin e fundit na shtrëngoi dorën të gjithëve dhe na tha: «Mirë u pafshim, shokë, në Shqipërinë e lirë!» Pas disa ditësh muarëm letrën e parë nga Parisi, të shkruar nga dora e Thanasit. Ai nuk e kishte harruar premtimin e dhënë. Në këtë letër na jepte mendimin e shokëve të Parisit se si të vepronim për të dalë nga Jugosllavia. Në fund shtonte: «Para se të niseni, na lajmëroni me telegram, që të dalim në stacion t'ju presim».

Për aktivitetin e Thanasit gjatë kësaj periudhe flet edhe Zylyftar Veleshnja. «Fati deshi, — tregon ai, — që ne të dy të ndiqnim pak a shumë të njëjtën rrugë, por pa u takuar asnjëherë në jetë dhe të njiheshim me njëri-tjetrin vetëm me anë të korrespondencës. Kur erdhi Thanasi në Greqi, ku ndodhesha edhe unë i emigruar, nuk u takuam dot, sepse në atë kohë qeveria greke mua dhe disa emigrantë të tjerë shqiptarë na kishte internuar në ishullin Zakynth. Pasi u lirova, u nisa menjëherë për në Jugosllavi. Në Beograd dëgjova se Thanasi ishte nisur për në Paris. Atëhere mora vesh adresën e tij dhe i shkrova letrën e parë. Përgjegjja më erdhi me njëherë. Mbaj mend se në këtë letër Thanasi më shkruante: «Vështirësia më e madhe për ju që jeni ende në Jugosllavi është sigurimi i vizës nga autoritetet jugosllave për në Francë. Po të rregullojni këtë punë e të vini këtu në Paris, puna është e zgjidhur. Ne kemi mundësi t'ju nisim për në Spanjë menjëherë me anë të një agjencie, që merret me dërgimin e vullnetarëve matanë Pirenejve.» Mirëpo ne u blokuam për një kohë të gjatë në Jugosllavi. Gjatë kësaj kohe unë kisha korrespondencë të rregullt me Thanasin për problemet dhe detyrat e luftës antizogiste dhe antifashiste».

Siç del nga burimet e asaj kohe, Thanasi, me të mbërritur në Paris, u takua me komunistët dhe patriotët e tjerë shqiptarë që zhvillonin në atë kohë aktivitet patriotik e revolucionar në kryeqytetin francez. Ata nuk e njihnin personalisht Thanasin, por arratisja e tij nga Shqipëria, dënimi nga gjyqi i Tiranës, burgosja në Rumani dhe aktiviteti i tij në Beograd nuk ishin gjëra të panjohura për ata

që ishin në krye të komunistëve shqiptarë dhe të patriotëve të tjerë në Paris. Kështu shpjegohet pritja e ngrohtë që ju bë Thanasit nga rrethet antifashiste të shqiptarëve të Francës dhe besimi që ju dha menjëherë atij..

Gjendja shëndetësore, që i ishte keqësuar nga vuajtjet pa mbarim, nuk e lejoi Thanasin të realizonte dëshirën e flaktë që të shkonte në Spanjë. «Me njëmijë mundime u lejua të shkonte në Francë, — thuhet në artikullin e përmendur në gazetën «Zëri i popullit», — ku u vendos për disa vjet, por gjithnjë me shëndet të thyer. Megjithëqë mushkëritë i ishte copë-copë, kërkoi që të shkonte të luftonte në Spanjë». Por shokët e tij, sipas këshillave të mjekëve, e ndaluan dhe e detyruan të shtrohej në një sanatorium të lirë pranë Parisit. Në këtë mënyrë, kjo periudhë tepër e vështirë e jetës së tij, e filluar me ndjekje, persekutime dhe burgime, u mbyll me vajtjen e tij për një kohë të pacaktuar në një sanatorium francez.

## NË FRONTIN E MADH TË LUFTËS KUNDËR FASHIZMIT

Në sanatorium Thanasi qëndroi pak kohë, shumë më pak nga koha që i kishin caktuar mjekët. Dhe kjo jo vetëm për arësye ekonomike. Komunistët shqiptarë që ndodheshin në Paris e vizitonin shpesh në sanatorium dhe i thoshin: «Mos u mërzi, Thanas! Fronti i luftës kundër Fashizmit është kudo, jo vetëm në Spanjë. Beteja të reja na presin dhe ne duhet të jemi gati për çdo gjë. Prandaj mundohu ta marrësh veten mirë, që të jesh gati për luftrat që kemi përpara...»

Dhe Thanasi e kuptonte mirë këtë gjë, por ishte një njeri që nuk mund të qëndronte i mbyllur në sallat e qeta të sanatoriumit.

Ndonëse i plagosur rëndë në kraharor, ai kërkonte të zbriste sa më parë në fushën e betejës, të ndodhej midis njerëzve për të përhapur idetë e tij dhe për të demaskuar pa mëshirë kundërshtarët e komunizmit. Të gjithë ata që e kanë njohur gjatë kësaj kohe në Paris thonë: «Thanasi mezi qëndroi pak muaj në sanatorium. Posa e ndjeu veten disi më mirë, kërkoi me këmbëngulje që të dilte. Në përgjithësi ai tre-

gönte një pakujdesi të pafalshme ndaj shëndetit të tij. Këshillat dhe kritikrat e shokëve për këtë gjë i pranonte dhe për një kohë tregohej më i kujdesshëm ndaj trupit të tij, por, me të filluar një betejë e re e një fushatë e madhe kundër armikut të klasës, ai hidhej me tërë forcat në luftë dhe harronte edhe udhëzimet e mjekëve edhe këshillat e shokëve. Një gjë e tillë ndodhte shpesh, pasi në atë kohë, në prakun e Luftës së dytë botërore, pa mbaruar mirë një fushatë e një betejë, fillonte tjetra më e madhe dhe më e ashpër se ajo e mëparshme».

Me të dalë nga sanatoriumi, Thanasi u vu plotësisht në dispozicion të Komitetit të çlirimit nacional me qendër në Paris. Kështu filloi një periudhë tjetër në jetën e tij, një periudhë luftrash revolucionare e betejash të ashpra në frontin e gjerë të luftës kundër fashizmit.

Mane Nishova, ish-vullnetar i brigadave internacionale në Spanjë, lidhur me aktivitetin revolucionar të Thanas Zikos në Francë, tregon: «Lufta e Spanjës ishte në pikën e saj më kulminante. Po luftohej në portat e Madridit, në vendin e baskëve dhe në brigjet e lumit Ebro. Në këtë luftë të ashpër, bashkë me popullin spanjoll derdhnin gjakun e tyre edhe vullnetarët internacionalistë, që kishin vajtur atje nga të gjitha anët e botës. Atë kohë unë kalova nga Parisi për të shkuar në Spanjë. Në kryeqytetin e Francës u takova për herë të parë me Ali Kelmendin, i cili ndodhej atje në atë kohë, si dhe me shumë patriotë të tjerë shqiptarë ndër ta dhe Thanas Zikoja. Mbaj mend mirë se Ali Kelmendi ishte bashkë me Thanasin. Për aktivitetin revolu-

cionar të Thanasit në Tiranë e në Berat unë kisha dëgjuar disa gjëra, por atë nuk e kisha njohur personalisht. Meqë shoqërohej me Ali Kelmendin i dhashë menjëherë besim dhe i fola me përzemërsinë që i flitet shokut të një ideali. Ishte hera e parë që shkoja në Paris dhe kisha dëshirë që gjatë këtij qëndrimi të shkurtyr të njihesha me kuriozitetet dhe monumentet kryesore historike të kryeqytetit francez. Ali Kelmendi e caktoi Thanasin të më shoqëronte. Kështu, u miqësova me të. Për sa ditë që qëndrova në Paris, kalonim disa orë së bashku. Vizitua vendet dhe monumentet që kishin të bënin me Revolucionin e madh francez e me luftën e Komunës e të proletariatit të Francës. Nja dy-tri herë shkuam në ekspozitën ndërkombëtare, që ishte hapur atë kohë në Paris. Për orë të tëra qëndronim në pavionin sovjetik dhe admironim sukseset që kishte arritur vendi i parë socialist në botë, i cili atë kohë ecte në rrugën e drejtë dhe qëndronte në pararojë të njerëzimit përparimtar. Ditën që do të nisesha për në Spanjë, Thanasi më shtrëngoi dorën e më tha: «Ah, sikur ta dije sa kam dashur të vija edhe unë në Spanjë, atje në vijën e parë të luftës kundër fashizmit! Por kjo sëmundja e mallëkuar më ka prerë hovin e më ka mbërthyer këtu. . .» U përqaftova si dy miq të ngushtë. Në letrat që i dërgoja Ali Kelmendit nga Spanja e pyesja gjithnjë për Thanasin. Dhe Aliu më përgjigjej: «Thanasi, megjithëse i sëmurë, vazhdon luftën në frontin tonë të përbashkët».

Gjatë atyre ditëve që qëndrova në Paris më lanë një përshtypje të thellë shpirti revolucionar dhe vendosmëria e papërkulur e Thanasit».

Gjendja ndërkombëtare po ashpërsohej çdo ditë

e më shumë. Në Evropë krijoheshin vatra të reja lufte. Shtetet agresive fashiste, duke përfituar nga përkrahja e fshentë dhe e tërthortë e fuqive të mëdha perëndimore, po gllabëronin vende të tëra dhe krahina të ndryshme të Evropës. Pushtimet dhe aneksimet ishin në rëndin e ditës. Re të zeza ngriheshin lart edhe mbi Ballkan. Pushtimet e njëpasnjëshme të diktatorit gjerman kishin hapur edhe oreksin e ortakut të tij në Itali, i cili lakmonte prej kohësh truallin e Shqipërisë. Italia fashiste e Musolinit kishite bërë çdo gjë gati për pushtimin ushtarak të Shqipërisë.

Përballë kësaj situate që po krijohesh, komunistëve dhe antifashistëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit u binte një barrë e rëndë për të demaskuar me forcë krimin e ri që po përgatitej nga fashizmi italian me inkurajimin e heshtur të fuqive të mëdha të Perëndimit. Së bashku me ta u hodh në luftë edhe Thanasi. Shokët e Komitetit të çlirimit nacional thonë: «Në prakun e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, Thanasin e gjeje kudo, në të gjitha qendrat e lokalet që frekuentoheshin nga shqiptarët. Fjala e tij ishte e ngrohtë, e përzemërt dhe bindëse. Thanasi komunikonte lehtë me studentët e punëtorët dhe u fliste atyre me pasion për rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga Italia fashiste e Musolinit. Ai dallohej në mënyrë të veçantë për luftën e pamëshirshme që bënte për demaskimin e pseudopatriotëve, të cilët, ndërsa nga njëra anë flisnin me fjalë të mëdha për Shqipërinë, nga ana tjetër përgatisnin fshehtëazi valixhet për t'u kthyer në atdhe bashkë me pushtuesit fashistë, me qëllim që të zinin pozita të larta e të siguronin rroga të majme. Thanasi u bë tmerri i

pseudopatriotëve. Sa herë që ai shkonte në ndonjë lokal të Parisit, ku mblihdeshin emigrantët shqiptarë, Kost Çekrezi largohej menjëherë, sepse s'mund të përballonte dot argumentat e fortë dhe thumbat e tij të goditur. Shkurt Thanasi ishte një nga aktivistët më të mirë të organizatës revolucionare të shqiptarëve në Francë».

Dy vjet pas vdekjes së Thanasit, gazeta «Zëri i popullit» shkruante lidhur me aktivitetin e tij në atë kohë: «Me mushkëri të copëtuara vinte qytet më qytet në Francë, vinte kudo ku kishte shqiptarë, që t'u shpjegonte se ç'është robëria e se kush na e solli Italinë në truallin tonë.

... Që në vjeshtë të 1938-ës Thanasi kishte demaskuar rolin e kryetarit të kolonës së pestë shqiptare, rolin e Mustafa Merlikës. Thanasi që i pari që demaskoi Qazim Koculin e disa krerë dallaveraxhinj të ish-«Bashkimit kombëtar», që u bënë vegla qorre të Mustafa Merlikës.

... Të gjithë inteligjencën e mprehtë të tij, të gjithë vullnetin e madh që kishte për luftën për liri, fjalën e tij të zjarhtë e gojën që e kishte si shpatë, i vuri në balancën e punës revolucionare.

... Thanasi me syrin e tij që xixëllonte, shikonte larg, shikonte të ardhmen, shikonte luftën e të gjithë bijve të popullit tonë kundër okupatorit.

... Thanasi që nga të parët që i vunë themelet Federatës shqiptare të Francës me qendër në Paris...»

Në kohën e ngjarjeve të mëdha në Shqipëri e në botë Thanasi u dërgua nga Federata Shqiptare e Francës në qytetin Grënobël. Në këtë qytet atë kohë ishte një grup jo i vogël studentësh shqiptarë, që



ndiqnin mësimet në universitetin e atjeshëm. Midis Grënoblit dhe Parisit ndodhet Lioni, ku jetonte një koloni relativisht e madhe të mërguarish shqiptarë. Në disa miniera që ndodheshin rreth Grënoblit dhe Lionit kishte shumë shqiptarë, të cilët punonin si minatorë. Përveç kësaj, jo shumë larg Grënoblit gjendet Gjeneva e Zvicrës, ku vepronte prej kohësh një nga grupet e nacionalistëve reaksionarë shqiptarë të emigracionit. Në atë kohë disa nga tradhëtarët shqiptarë si feudali famëkeq Ali Këlcyra dhe Qazim Koculi ishin larguar nga Gjeneva dhe qenë vendosur përkohësisht në Grënobël. Ishte e qartë se fashizmi italian po vinte në lëvizje të gjitha agjenturat e tij për të përgatitur 7 prillin edhe ndër shqiptarët që ndodheshin jashtë atdheut. Për këtë, edhe këta krerë të reaksionit në emigracion në prakun e 7 prillit lëviznin nga Zvicra në Francë, në mënyrë që të thurtnin më mirë fijet e tradhëtisë.

Petrit Dishnica, atë kohë student në Universitetin e Grënoblit, tregon për aktivitetin e Thanasit në këtë qytet francez: «Thanas Zikoja, të cilin unë e kam njohur për herë të parë në Paris në mbledhjen për themelimin e Federatës së shqiptarëve të Francës, na erdhi në Grënobël në një kohë kritike për fatet e Shqipërisë. Ai erdhi në këtë qytet si i dërguar i Federatës së shqiptarëve të Francës për të ndjekur nga afër veprimtarinë e pseudopatriotëve dhe për të qenë pranë studentëve dhe punëtorëve shqiptarë të këtij qyteti. Gjatë qëndrimit të tij në Grënobël, Thanasi ndiqte me vëmendje çdo lëvizje të tradhëtarëve shqiptarë dhe vepronte sipas rastit. Kohë pas kohe ai shkonte në Lion e në Paris për të mbajtur lidhjet me shokët udhëheqës të Fede-

ratës dhe për të marrë udhëzime të reja. Æe, studentët, përveç takimeve të përditshme, na thërriste e na shtronte detyra të reja, sipas udhëzimeve të Federatës. Të gjithë studentët shqiptarë të Grënoblit kishin respekt për Thanasin dhe e nderonin atë, si për aktivitetin e tij të mëparshëm, ashtu edhe për përpjekjet që ai bënte përditë kundër fashizmit dhe për përhapjen e ideve komuniste. Ai kishte fituar një emër të mirë midis shqiptarëve të Francës dhe besimin e plotë të Federatës së shqiptarëve të Francës. Nga ana tjetër, Thanasi ishte armik i dekluar i pseudopatriotëve shqiptarë, që ishin vënë në shërbim të shteteve të huaja dhe punonin për të përçarë forcat e emigrantëve. Ai ua përplaste në fytyrë veprimet dhe sjelljen e tyre tradhëtare dhe përçarëse... Ne, studentët e Grënoblit, e dinim mirë që Thanasi jetonte në vështirësi të madhe ekonomike, shpesh herë ai nuk kishte mundësi të blente ilaçet që i këshillonin mjekët. Ngandonjëherë nuk kishte të holla as për të paguar qiranë e asaj dhome të vogël ku banonte. Në kushte të tilla, po të mos kishte një karakter të fortë dhe një vendosmëri revolucionare të patundur, ai nuk do të mund t'u rezistonte dot mungesave dhe privacioneve të shumta».

Në ditët e stuhishme të 7 prillit të vitit 1939 dhe pas pushtimit të Shqipërisë prej hordhive fashiste Thanasi zhvilloi një aktivitet të gjithanshëm. Megjithëse i sëmurë dhe jorrallë me temperaturë, ai gjendej vazhdimisht midis shqiptarëve që ndodheshin në Grënobel dhe në vise të tjera të Francës Juglindore. Studentët shqiptarë ishin vënë në lëvizje kundër krimit të ri të fashizmit italian. Për-

krah tyre qëndronte proletariati francez dhe studentët përparimtarë në universitetet e Francës.

Ashtu si ndodhi në Shqipëri, që klasat shfrytëzuese dhe tradhëtarët e çdo kallëpi muarën anën e pushtuesit, edhe jashtë Shqipërisë pseudopatriotët treguan fytyrën e tyre të vërtetë tamam në ato çaste kritike. Në vend që të protestonin për shkeljen e atdheut nga një pushtues i egër e barbar, ata vrapuan në Shqipërinë e pushtuar për të lypur ndonjë kolltuk nga shkelësit e vendit e nga tiranët e popullit. «Tani ju gris maska një herë e mirë pseudopatriotëve, — thoshte në atë kohë Thanasi. — Populli i sheh se si veprojnë këta sahanlëpirës të fashizmit. Dhe këto i regjistrin të gjitha në kujtesën e tij. Nuk do të jetë e largët dita, që populli do t'u kërkojë hesap të gjithë atyre që mbajnë tabelën e patriotit, por kanë ndërgegjeje prej tradhëtari».

Në gjendjen e re që ishte krijuar pas pushtimit të vendit nga Italia fashiste detyra të reja më të mëdha e më të vështira u dëlnin përpara komunistëve kudo që ndodheshin, brenda apo jashtë Shqipërisë.

Edhe Thanasi ju përvesh punës me energji të reja, duke shkrirë të gjitha forcat e tij në luftë së bashku me shokët e tjerë të një ideali. Gjatë kësaj periudhe të fundit të jetës së tij ai zhvilloi aktivitetin më të madh revolucionar, që u ndërpre vetëm nga vdekja e parakohshme.

Dhimitër Shuteriqi, student edhe ai në atë kohë në Grënobël të Francës, në një artikull të veçantë me titullin: «*Duke kujtuar Thanas Zikon*» shkruan: «Kanë qenë vite shumë të vështira... për ne mërgimtarët, kur e kam njohur Thanas Zikon në Fran-

**çë. Unë** studjoja në universitetin e Grënoblit, një qendër e Francës Juglindore, pranë kufirit italian, rrëzë Alpeve... Thanasin e kam njohur ato dy vitet e fundit të jetës së tij, kur sëmundja ja kishte copëtuar mushkëritë, dhe e kam admiruar për qëndresën e për optimizmin e tij të madh. Nuk mbaj mend ta kem dëgjuar të qahëj një herë për shëndetin. Përkundrazi, kur ne shokët shqetësoheshim me të drejtë për të, se kishte ditë që shëndeti i keqësohej, ai përherë i buzëqeshur e i patronditur, na bënte dhe ne optimistë për të, na hiqte shqetësimin... Dhe mendjen ai e kishte në atdhe. «Ç'bëhet vallë në Shqipëri? Ne atje duhet të kthehemi sa më parë» — thoshte. Thanasi mendonte se, po të ishte në Shqipëri, edhe pse i sëmurë rëndë, ai do të mund të bënte punë për të çjerrë çdo maskë tradhëtari, të çdo sahanlëpirësi dhe vegle të fashizmit, që ai kishte njohur përpara dhe pas 7 prillit. Qazim Koculin, i cili pati marrë emër në Luftën e Vlorës më 1920, ai e urrente mbi të gjithë, si një të pabesë të fëlliqur, që kishte shkëlur gjakun e Selam Musait.

Njërin nga ata 28 nëntorë... unë me disa shokë e kemi kaluar bashkë me Thanasin duke qarë hallet e Shqipërisë. Kur kujtoj atë mbrëmje mërgimi, kur në atdhe flamuri kombëtar ishte mbërthyer me dy sopata të Liktorit, më del parasysh po ai Thanasi paepur në besimin e tij në të ardhmen e Shqipërisë, po ajo buçitje revolucionare që shpërthente nga gjoksi i tij i papërmbajtur, i fortë, ndonëse e shkallmonte kolla dhe kishte vjellë përsëri gjak. Thanasi jetonte atëhere në Latronshë, në një qytet të vogël klimaterik pranë Grënoblit... Atje vinim me radhë e rrinim me të, duke lënë mësimet ose punën, që

ai të mos mbetej vetëm e të mos mërzhitej, se nuk duhej të lëvizte, por të qëndronte në shtrat. Mirëpo Thanasi nuk mësohej dot me shtratin. Ai donte të ishte në këmbë, të lëvizte, të takonte sa më shumë shokë, të rrihte me ta problemet e ditës të botës e të Shqipërisë. Kështu që nganjëherë edhe e qërtanim për pakujdesinë që tregonte ndaj shëndetit...»

Më 1 shtator 1939, me sulmin e Gjermanisë hitleriane kundër Polonisë filloi Lufta e dytë botërore. Franca, ku punonte e jetonte Thanasi atë kohë, hyri në luftë që ditët e para të shtatorit. Qeveria borgjeze e Francës, në vend që të drejtonte tehun e luftës kundër Gjermanisë hitleriane, filloi një fushatë të shfrenuar kundër klasës punëtore dhe komunistëve. Në frontin e Rinit vazhdonte për muaj me radhë «lufta e çuditshme», që në fakt mund të ishte çdo gjë tjetër, por jo luftë e vërtetë. Borgjezia e madhe e Francës, duke marrë si pretekst traktatin gjermano-sovjetik të mossulmimit, të nënshkruar në gusht të vitit 1939 midis Gjermanisë e Bashkimit Sovjetik, ngriti një fushatë të madhe kundër komunistëve dhe forcave të tjera përparimtare në vend. «Bashkimi Sovjetik dhe gjithë komunistët kudo që u ndodhën u bënë aleatë të Gjermanisë hitleriane» — trumbetonin me zhurmë shurdhuese reaksionarët e çdo kallëpi, që nga obskurantistët e kishës katolike e gjer te socialdemokratët hipokritë, që me parulla pseudosocialiste bënin lojën e borgjezisë. Në kushte të tilla, puna e komunistëve, që ndodheshin atë kohë në Francë, ishte bërë jashtëzakonisht e vështirë. Shumë aktivitete të tyre, që gjer atëhere zhvilloheshin legalisht, kaluan menjëherë në ilegalitet. Në këto çaste të vështira Thanasi Zikoja tregoi një qartësi të

madhe për problemet politike dhe një vullnet të pathyeshëm përsa i përket vazhdimit e zgjerimit të luftës kundër fashizmit e reaksionit. Shokët e tij më të ngushtë tregojnë se ai nuk e humbi as edhe për një çast perspektivën. Lidhur me traktatin gjermano-sovjetik të mossulmimit ai u thoshte shokëve: «Gjersa e bëri Stalini këtë traktat, do të jetë me siguri për të mirën e proletariatit dhe të popujve që rrezikohen nga fashizmi».

Ngjarjet e mëvonshme treguan fare mirë vërtetësinë e këtyre mendimeve dhe arësytetimeve. Pas disa muajve divizionet e motorizuara gjermane shpartalluan brenda pak javëve ushtrinë franceze dhe invaduan gjithë vendin. Tradhëtia e borgjezisë së madhe franceze doli hapur në shesh. U pa edhe një herë se sa i drejtë ishte mësimi që kishin nxjerrë prej kohësh marksistët e vërtetë, që borgjezia s'ka më atdhe, që borgjezia, për interesat e saj të klasës, e shet atdheun kur të duash.

Pas pushtimit të Francës, Grënobli dhe departamentet e tjera të Jugut kaluan nën administrimin e shtetit vasal të Vishisë. Si kudo në Francë, edhe këtu pushtuesit hitlerianë së bashku me terrorin sollën edhe urinë. Gjendja e emigrantëve shqiptarë u bë jashtëzakonisht e vështirë. Thanasi i sëmurë vuajti së tepërmi gjatë kësaj periudhe kritike. Shokët e tij shqiptarë e ndihmuan, por në këtë kohë edhe buri met e tyre kishin shteruar thuajse plotësisht. Nga sa kallëzojnë miqtë e tij më të ngushtë, një përkrahje e mbështetje të madhe Thanasi gjeti në këtë periudhë kritike te punëtorët internacionalistë francezë, të cilët e përkrahën në çdo rrezik dhe e mbajtën me atë që kishin.

Kushtet e punës dhe të aktivitetit revolucionar kishin ndryshuar rrënjësisht. Çdo veprimtari revolucionare kishte kaluar në ilegalitet. Qendrat e studentëve në Grënobël ishin prishur. Shumë studentë po ktheheshin në shtëpi. Edhe nga punëtorët shqiptarë, pas pushtimit të Francës nuk ishin të paktë ata që kishin marrë rrugën e riatdhesimit për në Shqipëri.

Por me gjithë vështirësitë e jashtëzakonshme, Thanasi nuk e ndërpreu aspak veprimtarinë e tij revolucionare. Krahas aktivitetit të përditshëm, ai gjente kohë që të studjonte gjithnjë më shumë e më mirë teorinë marksiste. Shokët e tij të ngushtë, kur i shkonin në mbrëmje në dhomë, e gjenin gjithnjë me libër në dorë. Dhimitër Shuteriqi, për këtë përpjekje të veçantë që bënte Thanasi, shkruan: «...Në shtëpi, e pata gjetur më se një herë tek lexonte letërsinë komuniste, tani më e rrezikshme po ta gjente policia e regjimit tradhëtar të Petenit. Lexonte jetën e Marksit nga Lenini, «Çështjet e leninizmit», nga Stalini, «Historinë e PK Bolshevike» dhe vepra të tjera si këto. Me frëngjishten kishte nisur të mos kishte vështirësi të mëdha, po prapë dukej se nuk arrinte të kuptonte çdo gjë dhe puna me fjalorin e lodhte. «Ah, bre, kur t'i kemi shqip këto libra!» thoshte ai...»

Pas pushtimit të krejt Francës nga ushtria e Hitlerit, Thanasi vajti në Paris për t'u takuar me shokët e Federatës shqiptare dhe për të marrë udhëzime të reja. Udhëheqja e Federatës e ngarkoi atë me një mision të posaçëm në Jugosllavi, ku duhej të takohej me emigrantët dhe studentët shqiptarë në Beograd e në Zagreb. Pasi të mbaronte punën atje, duhej të kthehej në atdhe, ku, siç shkruante nja dy vjet më

vonë gazeta «Zëri i popullit», «e priste nëna e tij, që e kishte rritur si bir të vetëm që e kishte, me shumë të mira e përkëdhelje, por me zemër luani».

Thanasi u nis nga Grënobli për në Beograd së bashku me Ptoleme Xhuvanin që studjonte në atë qytet dhe paskëtaj do të vazhdonte studimet në Itali. Udhëtimi që i vështirë, sepse rrugët dhe të gjitha mjetet e komunikacionit ishin në duart e pushtuesve. Në çdo stacion pasagjerët kalonin në një kontroll të rreptë. Në kufirin franko-italian i mbajtën një natë të tërë. Kur mbërritën në Torino e ndërprejnë udhëtimin për disa ditë. Ishte kohë lufte dhe në Itali kishte kufizime të mëdha. Hotelet ishin të zëna nga komandat ushtarake dhe mezi arritën të siguronin një vend për të fjetur. Thanasi ishte ngarkuar nga shokët e Federatës së komunistëve shqiptarë të Francës me detyrë që të takohej me studentët shqiptarë, që atë kohë vazhdonin studimet në universitetin e këtij qyteti të madh të Italisë së Veriut. Midis të tjerëve ai u takua edhe me Nako Spirun, atë kohë student në Torino. Ata që e shoqëronin Thanasin nuk muarën pjesë në këtë takim, prandaj nuk dihet me hollësi se çfarë u bisedua midis tyre. Por nga sa u kishte folur Thanasi shokëve të tij më vonë, të dy komunistët kishin këmbyer mendime për intensifikimin e luftës kundër fashizmit italian dhe për detyrat e studentëve në këtë gjendje të re që ishte krijuar në Shqipëri e në Evropë, pas ngjarjeve të dy vjetëve të fundit. Duke vazhduar udhëtimin përmes Italisë, Thanasi qëndroi në Firence, për t'u takuar me Qemal Stafën, i cili ishte atje student. Për këtë takim të rëndësishëm, organi qëndror i Partisë Ko-



muniste Shqiptare gazeta «Zëri i popullit» në një artikull për Thanas Zikon shkruante dhe këto: «Thanasi para se të shkonte në Beograd shkoi përmes Italisë, ku u poq me Qemal Stafën e të tjerë. Të dy këta djem, të dy këta revolucionarë komunistë besën që i dhanë njëri-tjetrit e mbajtën e vdiqën për një qëllim: për lirinë e këtij populli». Ky takim i Thanas Zikos me Qemal Stafën duhet vlerësuar edhe nga një pikëpamje tjetër. Dihet se Qemali ishte anëtar i Grupit Komunist të Shkodrës, ndërsa Thanasi i kishte përkatur dikur Grupit të Korçës. Vetë fakti i takimit të tyre tregon se këta dy militantë komunistë qëndronin mbi grupet dhe e kishin të qartë perspektivën e shkrirjes së grupeve për formimin e një Partie Komuniste të vërtetë.

Nga Firencja Thanasi u drejtua për në Romë. Në kryeqytetin e Italisë ai krijoi menjëherë lidhje me Vasil Nathanailin, i cili atë kohë ishte përgjegjës i një celule të Grupit të Korçës, që përbëhej nga studentë shqiptarë në universitetin e atjeshëm. Për qëndrimin dhe punën e Thanasit në Romë Vasil Nathanaili tregon: «Thanas Zikoja erdhi në Romë dhe u takua me mua e me Taqi Skendin, i dërguar nga Nako Spiru, atëhere student në Torino. Gjatë takimeve që bëmë, biseduam për problemet kryesore të asaj kohe dhe mbi të gjitha për organizimin e luftës kundër pushtuesve fashistë e për nevojën e bashkimit të të gjithë komunistëve shqiptarë në një parti të vetme. Më ka bërë përshtypje se Thanasi e dënonte ndarjen e komunistëve në grupe dhe ngul-te këmbë se kishte ardhur koha për formimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Atë kohë që studjonim në Itali ne na shqetësonte në mënyrë të veçantë një gjë:

Fashizmi italian kërkonte të rekrutonte studentë shqiptarë për t'i dërguar në frontin e luftës italo-greke. Për këtë qëllim përdorte një propagandë të madhe e një demagogji të rafinuar. Ne bënim çmos që ta sabotonim këtë plan të fashizmit. Thanasi jo vetëm që ishte i një mendimi me ne, por gjatë qëndrimit të tij në Romë punoi me studentët shqiptarë për t'i sqaruar që të mos binin në grackën e propagandës armike... Thanasi atë kohë ishte shumë i sëmurë. Kur diskutonte me zjarr për problemet e luftës, ai detyrohej ta ndërpriste shpeshherë bisedën, sepse i zihej fryma. Por që në takimin e parë të jepte përshtypjen se ishte një shok i vendosur në luftë dhe i qartë në mendime. Ne të Romës u interesuam për kthimin në Shqipëri të Thanasit e të shokëve të tjerë që vinin nga Franca, Por Thanasi na tha: «Të dy shokët e mi do të kthehen drejt për së drejti në Shqipëri, ndërsa unë do të kaloj nga Jugosllavia, se jam i ngarkuar me një punë në Beograd e në Zagreb». Dhe kështu u bë. Pas disa ditësh Thanasi u nis nga Roma me tren për në Jugosllavi.

Mbaj mend mirë, — shton Vasili, — se kur u ktheva në Tiranë dhe i raportova shokut Enver për gjithë aktivitetin e celulës sonë në Romë, midis të tjerave i fola hollësisht edhe për takimin tonë me Thanas Zikon e për problemet që kishim biseduar. Dhe shoku Enver më tha: «Mirë keni bërë që jeni takuar me Thanasin, se ai vinte me mision nga komunistët shqiptarë të Francës».

## «DHE PËR FITORE KAM ME RA FLI»

Kështu këndonte poeti i rinisë për «të birtë e shekullit të ri». Dhe Thanasi Zikoja ishte një nga ata bij të këtij shekulli të revolucioneve e të tronditjeve të mëdha shoqërore, që çuan «grushtin për me luftue ndër lufta të reja dhe me fitue». Thanasi ishte moshatar me Migjenin. Ai kishte lindur në vitin 1910, ndërsa Migjeni një vit më vonë. Që të dy luftuan për një të ardhme të bukur të popullit, sado që nga kënde shumë të ndryshme e mund të thuash të largëta. Që të dy i mundonte fati i hidhur i vegjëlisë. Që të dy ishin prekur po nga ajo sëmundje dhe më në fund vdiqën larg atdheut, të cilit i falën edhe jetën.

Nuk dihet me siguri se në ç'datë u nis Thanasi nga Roma për në Jugosllavi. Vetëm një gjë është e dokumentuar plotësisht se ai mbërriti në Beograd në palcë të dimrit. Klima e ashpër kontinentale e kryeqytetit jugosllav ja keqësoi menjëherë gjendjen shëndetësore. Megjithatë ai çante rrugët e qytetit të mbuluar me borë dhe shkante nga një vend në tjetrin për t'u takuar me patriotët shqiptarë, për të vendosur lidhje me studentët e për të shtruar detyrat

e reja që u dilyn shqiptarëve që ndodheshin përko-hësisht larg atdheut.

Sipas udhëzimeve që kishte marrë nga qendra e Federatës në Paris, Thanasi, pas takimeve të veçanta me shokët, organizoi një mbledhje me të gjithë komunistët dhe antifashistët shqiptarë në Beograd e në qytetet e afërta. Për këtë mbledhje dhe për gjithë aktivitetin e Thanasit në Jugosllavi në këtë fazë të fundit të jetës së tij, Stefo Grabocka, i emigruar politik atë kohë, tregon:

«Që prej pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, me porosi të udhëheqjes së Grupit të Korçës, kisha emigruar në Jugosllavi, së bashku me dy-tre shokë të tjerë, për t'u shpëtuar ndjekjeve të armikut. Qeveria jugosllave na internoi menjëherë në një qytet të vogël e të humbur të Banatit, që quhej Bella Cerkva. Ne, megjithëse larg Beogradit, mbanim lidhje të rregullta me shokët e tjerë, që ndodheshin atë kohë në kryeqytetin e Jugosllavisë. Aty nga fillimi i dhjetorit të vitit 1940 u lajmëruam që të nesërmen të ndodheshim në Beograd. U nisëm menjëherë nga vendi i internimit për në kryeqytet. Atje na thanë se do të merrnim pjesë në një mbledhje, ku do të na shtronte detyrat e reja, lidhur me aktivitetin revolucionar, një i dërguar nga Federata e komunistëve shqiptarë në Francë. Mbledhja u bë pasdite në një dhomë të hotelit «Ballkan». Në këtë mbledhje merrnin pjesë 15-20 veta. Së bashku me disa emigrantë të njohur për mua, hyri në dhomë edhe i deleguari që do të na fliste. Sa u habita unë kur pashë se ky ishte Thanas Zikoja! Unë atë e njihja mirë që nga koha kur ai ishte me punë pranë gjykatës së Korçës. Atë kohë ai ishte i paorganizuar në Grupin e Korçës,

por njihej prej nesh si element përparimtar dhe antizogist i bindur. Tani ai vinte si i deleguar nga Federata e komunistëve shqiptarë në Francë, që atë kohë gëzonte një autoritet të madh në radhët e komunistëve dhe të antifashistëve jashtë Shqipërisë.

Në atë mbledhje Thanasi parashitroi detyrat e reja që dilnin për ne, lidhur me gjendjen e re që ishte krijuar në Shqipëri e në botë pas pushtimit të pjesës më të madhe të Evropës nga ushtritë fashiste të Hitlerit e të Musolinit.

Pas mbledhjes unë së bashku me Thanasin e me një shok tjetër vajtëm për të ngrënë darkë në një restorant. Rrugët ishin të ngrira. Binte borë dhe frynte një erë që të thante. Thanasi i sëmurë mezi merrte frymë. Nja dy-tri herë na u desh që ta mbanim prej krahu, se s'mund të ecte dot dhe mund të rrëzohej përdhe. Kur vajtëm në restorant, na tha se pas dy ditësh do të nisej për në Zagreb. Ne i thamë se do ta kishte shumë të vështirë të bënte një udhëtim të tillë në mes të dimrit. «Vështirë, po, por e pamundur jo» na e ktheu ai duke buzëqeshur. Të nesërmen ne e ndihmuam që të takohej me disa studentë kosovarë, që mbanin lidhje me shokët tanë. Ditën që ai u largua për në Zagreb, ne u nisëm për në Bella Cerkva të Banatit, sepse na ishte mbaruar leja prej tri ditësh që na kishin dhënë autoritetet lokale. Mirëpo s'kaluan shumë ditë dhe nga Beogradi na lajmëruan që të shkonim përsëri atje, sepse Thanasi ishte duke dhënë shpirt. Dhe u nisëm menjëherë...»

Ja ç'kishte ndodhur gjatë atyre ditëve. Thanasi vajti në Zagreb për të plotësuar detyrën që kishte marrë përsipër. Rrugës vuajti shumë. Në Zagreb të

ftohtit ishte edhe më i madh se në Beograd. Megjithatë, ai i bëri të gjitha takimet që kishte në plan me patriotët dhe studentët shqiptarë që ndodheshin atje. Kështu që ai gjithë ditën ndodhej në lëvizje. Natën flinte në një hotel të vjetër të kategorisë së fundit. Ditën e fundit e ndjente veten të lodhur e të dërmuar. Si duket, kishte edhe temperaturë. Por në thellësi të shpirtit ndjente një kënaqësi, se misionin e ngarkuar e kishte plotësuar si duhet. Në Jugosllavi s'kishte më punë tjetër. Me rastin më të parë ai do të nisej për në atdhe, ku e prisnin e ëma, gruaja, vajza e vogël, shokët. Rrugës për t'u kthyer në Beograd në vagonin e klasës së tretë, pështyu pak gjak. Por nuk i dha ndonjë rëndësi, sepse ai edhe herë të tjera kishte pështyrë gjak. Me të zbritur në stacionin hekurudhor të Beogradit volli shumë gjak dhe ra pa ndjenja. Rreth këtij njeriu të panjohur, me një valixhe të vogël në dorë, u mblodhën shumë kurreshtarë. Gjendja e tij ishte e dëshpëruar. Nga çasti në çast mund të jepte shpirt. Shërbimi i ndihmës së shpejtë e mori në një ambulancë dhe e çoi në sanatoriumin e të varfërve jashtë Beogradit. Atje, në atë institucion të zymtë, Thanasi kaloi ditët e fundit të jetës së tij. Ditët e para shokët e Beogradit nuk e kishin marrë vesh atë që kishte ndodhur, kështu që Thanasi mbeti i vetëm, në një ambient të ftohtë e të mërzitshëm, midis njerëzve të huaj e të panjohur. Nga sanatoriumi më 21 dhjetor 1940 ai u dërgoi një letër të shkurtër shokëve të Federatës në Francë, ku, midis të tjerave, u shkruante: «Kam katër ditë që ndodhem në spital, i sëmurë për vdekje... Do të jetë një mrekulli po ta kaloj këtë herë. Kam vjellë përditë gjak. Natën e datës 18 me ambulancë më sollën këtu në vdekjen time e të të gjithë fukarenjve...»

Kjo ishte letra e tij e fundit. Ndërkohë shokët e muarën vesh se ai qe shtruar në sanatorium dhe ju mblodhën rreth shtratit. Tani Thanasi e ndjente veten më mirë. Ai nuk ishte më i vetmuar, megjithëse ndodhej larg familjes, në një vend të huaj. Duke qenë në shtratin e vdekjes, ai e shihte mirë se kishte dy gjëra që nuk do ta braktisnin kurrë: idealin për të cilin po flijonte jetën, dhe shokët e idealit, që në çastet më të vështira nuk ju ndanë as edhe një minutë. Në duart e shokëve të tij ai mbylli sytë për gjithnjë më datën 24 dhjetor 1940.

Kjo datë përmendet nga gazetatat e kolonive shqiptare si data e vdekjes së Thanasit. Në artikujt e ndryshëm që u shkruan më vonë, përmenden edhe data të tjera, si 16 janari e shkurti i vitit 1941. Por datë më e saktë është ajo e 24 dhjetorit 1940. Nga letra e tij prej sanatoriumit të Beogradit të datës 21 dhjetor 1940 del se ai ishte në çastet e fundit të jetës. Pra, 16 janari, apo shkurti i vitit 1941, do të jenë datat kur arriti lajmi i vdekjes së tij në rrethet e shokëve dhe të bashkëpunëtorëve të tij brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Thanasi sapo kishte mbushur 30 vjet. Në varrimin e tij morën pjesë shumë shqiptarë antifashistë me qëndrim në Jugosllavi. Përveç atyre që banonin në Beograd, kishin ardhur edhe të internuarit në Banat, studentët shqiptarë të Zagrebit si dhe disa studentë kosovarë në Universitetin e Beogradit.

Ishte një ditë e ftohtë dimri. Binte borë pa pushim. Shokët e Thanasit dhe patriotë të tjerë shqiptarë, që kishin ardhur këtu prej së largu për t'i dhënë lamtumirën e fundit shokut të tyre të shtrenjtë, që, besnik i idealit të tij, kishte vdekur jashtë atdheut

e larg familjes së tij, e përcollën trupin e tij gjer në varrezat e qytetit.

Përpara një varri të hapur dhe në qetësinë e thellë të asaj dite dimri u dëgjua befas një zë që dridhej nga mallëngjimi: «Nuk je i pari, ti Thanas, — tha, midis të tjerave, Stefo Grabocka në fjalimin që mbajti para varrit të hapur të shokut, — nuk je i pari ti, që dhe jetën për të mbrojtur idealin tonë të lartë dhe interesat e popullit tonë të shumëvujtur. Të tjerë para teje kanë dhënë jetën për çështjen e madhe të çlirimit të popujve nga fashizmi gjakatar. Shumë të tjerë pas teje do të bien në barrikatadat e luftrave çlirimtare, gjersa të çlirohen popujt që vuajnë nga skllavëria e nga shfrytëzimi. Mbi eshtrat tuaja popujt e çliruar do të ngrejnë një ditë, në një të ardhme jo të largët, një panteon të madhërishëm, dhe do të nderojnë brez pas brezi të gjithë ata që dhanë jetën për çështjen e madhe të çlirimit. Fli i qetë, o bashkëluftëtari ynë i dashur! Ne betohemi para varrit tënd të hapur, se do të vazhdojmë luftën që kemi nisur së bashku, gjer në çlirimin e plotë të popullit! Lamtumirë, Thanas!»

Pas Stefo Grabockës foli edhe një student kosovar. Pastaj shokët e tij të luftës vendosën mbi varrin e Thanasit një kurorë të thjeshtë.



## DËSHIRA E TIJ E FUNDIT

Lajmi mbi vdekjen e parakohshme të Thanas Zikos u përhap shpejt në të gjitha kolonitë shqiptare jashtë atdheut dhe në të gjitha vendet ku kishte studentë shqiptarë e patriotë të emigruar. Ky lajm i zi kaloi edhe kufirin e Shqipërisë së skllavëruar dhe hidhëroi pa masë shokët e bashkëluftëtarët e Thanasit. Gjithë njerëzit e vegjëlisë, që te komunistët shihnin luftëtarët e paepur për çlirimin e atdheut dhe për interesat e popullit, u prekën nga vdekja e Thanasit. Mandata e zezë mbërriti edhe në fshatin Sopik të Pogonit. Atë ditë dimri në këtë fshat edhe dy gra të tjera u veshën me të zeza: e ëma e Thanasit, Kaliopi Ziko dhe e shoqja, Avjerini.

Shtypi i shiur i asaj kohe, që i shërbente push-tuesit, ngrinte në qiell tradhëtarët dhe sahanlëpirësit e fashizmit, ndaj s'kishte si të shkruante për luftëtarët e lirisë, që jepnin edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën, për çlirimin e popullit e të atdheut. Por, me gjithë heshtjen e shtypit, lajmi mbi vdekjen e Thanas Zikos u përhap gojë më gojë në të katër anët e vëndit. Ky lajm do të ketë arritur edhe në veshët e atyre, që e kishin ndjekur, e kishin persekutuar dhe

dënuar me 10 vjet burg jo shumë kohë më parë. Atyre atë kohë as që mund t'u shkonte në mendje se pa kaluar tre vjet nga vdekja e kundërshtarit të tyre populli do të ngrinte një batalion të tërë me emrin e Thanas Zikos, një batalion me dyqind pushkë partizane e me dyqind zemra plot zjarr, të frymëzuara nga ideali i madh për të cilin kishte dhënë jetën Thanasi. Batalione të tjera me emra martirësh dhe heronjsh, që do të mbushnin malet dhe fushat e Shqipërisë, do të merrnin hakun për të gjitha padrejtësitë që ishin bërë në kurriz të popullit.

Organi i Partisë Komuniste Shqiptare, që sapo ishte formuar, gazeta «Zëri i popullit» në një nga numrat e saj të para, i kushtoi një artikull të frymëzuar Thanas Zikos me titull: «Pëmbi varrin e një luftëtari». Ky artikull, pasi përshkruante gjithë jetën e Thanasit, përfundonte me këto fjalë:

*«Vdiq në Jugosllavi, ku kishte vajtur në emër të Federatës si anëtar i Komitetit Qarkor që ishte, për të hedhur zënë e bashkimit e të organizimit e që andej të kthehej në Shqipëri ku e priste nëna e tij, që e kishte rritur si bir të vetëm që e kishte, me shumë të mira e përkëdhelje, por «me zemër luani».*

*Thanasi do të kthehej në Shqipëri në gjirin e ngrohtë të shokëve revolucionarë që i donte dhe i çmonte aq shumë, do të kthehej në Shqipëri që të vazhdonte luftën për liri. Edhe Thanasi porsi Avniu<sup>1</sup>) e porsi Aliu<sup>2</sup>) «rroj e vdiq zemër luani për liri».*

Po gjatë luftës një gazetë e një kolonie të largët shqiptare shkruante për vdekjen e Thanasit: «Në

---

1) Avni Rustemi.

2) Ali Kelmendi.

Beograd më 24 shënëndre vdiq në lulën e djalërisë Thanas Zikoja, një kalorës pa njollë edhe pa frikë, që kishte pjellë dhe regjur lufta e popullit shqiptar kundër regjimit të Zogut dhe sidomos kundër sundimit të imperializmit italian. Thanasi ishte një nga përfaqësuesit e shkëlqyer të brezit të ri të luftëtarëve, të cilët luftën dhe fatin e tyre e kishin lidhur ngushtë me punëtorët e fshatarët e Shqipërisë. Ai ishte nga raca e Halim Xhelos, Ali Kelmendit, Asim Vokshit, Teni Ikonomit, nga raca e një plejade heronjsh të panjohur.

... Kur u hap Lufta e Spanjës pa një pa dy ai mori udhën e mërgimit me qëllim që të soste atje ku kishin vajtur edhe shokët e tjerë, në frontin e lirisë. Po burgjet në Jugosllavi e në Rumani si dhe vuajtjet e tronditën trupin e tij të fortë dhe një sëmundje e pamëshirshme e mbërtheu në shtrat... Vdekja e Thanasit është një humbje e madhe për ne... Thanasi në Federatën e Francës ka luajtur një rol të dorës së parë dhe ka treguar një aktivitet të rrallë dhe një entuziazëm të pashoq në luftë... Thanasi do të ishte sot sidomos në krahinën e Gjirokastrës, si minoritar që ishte, një element i madh bashkimi për popullin shqiptar. Vdekja na e rrëmbeu nga radhët tona përpara kohës, të munduar nga burgjet e nga vuajtjet e mërgimit».

Në një mënyrë krejt ndryshe dhe pak si të çuditshme e muarën vesh lajmin e vdekjes së Thanasit vullnetarët shqiptarë që atë kohë ndodheshin në kampet fashiste të përqëndrimit në Francë. Një ditë shkurti të vitit 1941 ata të kampit të Guksit muarën një manda-postë me 75 franga franceze. Manda-posta vinte nga Beogradi dhe kishte vetëm një shënim: «Nga Thanas Zikoja.»

Për arsye të kontakteve të kufizuara që kishin me botën, të internuarit në këtë kamp e dinin që Thanasi ndodhej në Francë. Atëhere përse kjo shumë e vogël vinte nga Beogradi? Mos kishte pësuar gjë Thanasi? Më vonë, kur u arratisën nga kampi dhe u takuan me shokët e tjerë, morën vesh këto hollë-sira:

Thanasi, ditën që ra pa ndjenja në stacionin hekurudhor të Beogradit dhe u shtrua në sanatoriumin e të varfërve, kishte në xhep vetëm 75 franga fraceze të kohës. Kjo ishte e tërë pasuria e këtij luftëtari të paepur të lirisë... Në çastet e fundit, para se të mbyllte sytë përgjithnjë, u tha shokëve që i rrinin pranë shtratit: «Këtu nën jastëk është kuleta ime. Atje kam 70-75 franga. Merrini dhe dërgojani shokëve tanë që luftuan në interbrigadat në Spanjë dhe që tani dergjen në kampet e përqendrimit». Shokët u munduan ta qetësonin, duke i thënë se do të bëhej përsëri mirë. Po ai ua bëri me shenjë se s'kishte më nevojë për fjalë dhe me zë të mekur përsëriti: «Ju lutem, mos harroni atë që ju thashë!» Kjo ishte dëshira e tij e fundit. Thanasi edhe në çastet më të vështira të jetës mendjen e kishte te shokët, te bashkëluftëtarët e idealit, që do ta çonin më tej drejt triumfit, çështjen për të cilin ai kishte flijuar jetën...

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Një emër që mbeti në histori .....	3
Nisja e shtegtimeve .....	9
Fragmente nga ëndërrimet e një të riu .....	15
Për bukën e gojës .....	24
«Ne jemi shumë moj nënë» .....	36
Ballë për ballë me regjimin e Zogut .....	61
Burgje dhe sanatoriume .....	74
Në frontin e madh të luftës kundër fashizmit .....	84
Dhe për fitore kam me ra fli .....	99
Dëshira e tij e fundit .....	105



Redaktor: SONJA VILA

Kopertina nga: SAFO MARKO

Tirazhi 4.000 kopje    Format 70 x 100/32    Stash: 2204 - 72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973